

Organ i aktivistëve dhe intelektualëve shqiptarë demokristianë në Vjenë



BULETIN INFORMATIV

Nr. 12-mars 2013

del një herë në 3 muaj

“Dielli i shqiptarëve lind në perëndim” (Faik Konica)

# DIELLI DEMOKRISTIAN



## Orë letrare në Vjenë

Shoqata kulturore “Aleksandër Moisiu” promovoi veprat “Pelegrin” dhe “Illyricum”... (faqe 4-5)



Lahutari pikurë nga piktori Hachi Gashi

## Lahuta

Nder instrumentet më të vjetra muzikore në Evropë dhe në Ballkan. Ky instrument ... (faqe 30)



Lahutar nga Merturi Pukë.



## Mbahet turneu i shahut

Për ndër të pesë vjetorit të pavarësisë së Kosovës klubi shqiptar i shahut “Arbëria” organizoi ... (faqe 34)



*Bac, tash e pesë vjet,  
jemi shtet!*

**Urime 5 vjetori i pavarësisë së Kosovës!**

**FJALA E REDAKSISË**

Të nderuar lexues,

Kemi nderin dhe kënaqësinë e veçantë t'ju përcjellim numrin e dymbëdhjetë të revistës sonë dhe tuaj "Dielli Demokristian"-Vjenë. Përgjatë më shumë se dy viteve e gjysmë vazhdojmë të ju informojmë për aktivitetet e zhvilluara në javët dhe muajt që lëmë pas. Poashtu me përkushtim vullnetar po bëjmë të mundur edhe vazhdimin e botimit edhe të një versioni të shkurtër edhe në gjuhën gjermane. Në ndërkohë, këshilli redaktues i revistës "Dielli Demokristian" ka vënë në funksion edhe web-faqen në internet: [www.diellidemokristian.eu](http://www.diellidemokristian.eu). Për më tepër, që nga fillimi i viti të kaluar kemi hapur një faqe për komunikim me ju në platformën e rrjetit social "Facebook" me emrin Dielli Demokristian. Pra, ju mirëpresim!

Revista "Dielli Demokristian" në Vjenë kësaj radhe sjell shkrime nga bashkëpunëtorët e shumtë nga Austria, Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Franca, Zvicra dhe Australia.

Një risi pozitive kësaj here paraqet numri i lartë i shkrimeve që kemi marrë nga intelektualët dhe aktivistët shqiptarë në Austri. Respekt për këtë! Poashtu do të keni mundësi të lexoni edhe për ngjarjet që u zhvilluan në Vjenë, Linc, Salzburg, Grac, Wiener Neustadt, Baden e qytete të tjera në Austri. Vlen të veçohen orët letrare dhe promovimet e librave të shumtë, ndër ta edhe e antologjisë së parë të krijuesve shqiptarë në Austri "Illyricum" nën organizimin e shoqatës kulturore "Aleksandër Moisiu"-Vjenë. Do njiheni edhe me përgatitjet për fillimin e sezonit të ri të Ligës Shqiptare të Futbollit në Austri (LSHFA), në këtë kuadër edhe me sukseset e klubit të parë shqiptar në futboll të madh, SV Albania, i cili garon në ligën e katërt austriake. Lajm tjetër sportiv është themelimi i klubit të shahut "Arbëria" me seli në Vjenë.

Në ndërkohë, ka disa muaj që është iniciuar dhe po diskutohet ideja e themelimit të klubit të debatit "Forumi Shqiptar në Austri" si një mekanizëm konkret i cili do të adresojë sfidat me të cilat ballafaqohet komuniteti shqiptar në Austri, si dhe do të dalë me propozime për përmirësimin e gjendjes aktuale. Pjesëmarrës pritet të jenë 20-25 persona të përzgjedhur dhe të dëshmuar si aktivistë dhe bartës të proceseve shoqërore dhe integruese në Vjenë dhe më gjerë. Në këtë edicion do të njiheni më për së afërmi me këtë koncept.

Edhe në këtë numër do të mund të lexoni analiza që merren me zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në hapësirat shqiptare. Numri i njohjeve të Kosovës ka shkuar në 99, ndërsa në Maqedoni do të mbahen zgjedhjet me 24 mars dhe në Shqipëri me 23 qershor të këtij viti.

Me këtë rast urojmë të gjithë shqiptarët kudo në botë-gëzuar 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë dhe 5 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Dy shtet tona që flasin një gjuhë. Flasin shqip.

Për më shumë lidhur me ne dhe temat që kemi ngritur edhe më tutje ju mund të na shkruani në adresën elektronike: [dielli.demokristian@gmail.com](mailto:dielli.demokristian@gmail.com). Numri i radhës i revistës në formë elektronike "Dielli Demokristian", Vjenë do të dalë në qershor të vitit 2013.

Këshilli redaktues falenderon të gjithë ata që ndihmuan në realizimin dhe botimin e kësaj reviste periodike, e sidomos ata që dërguan shkrimet e tyre, si dhe mbështetësit tanë moral. Si dhe deri më tani, edhe ky numër është përpiluar, dizajnuar dhe botuar në saje të punës dhe angazhimit vullnetar të aktivistëve tanë, pa asnjë kompensim financiar, dhe si i tillë do shpërndahet në mijëra adresa elektronike të lexuesve në të katër anët e botës.

Lexim të këndshëm!

Të drejtat e autorit: @dielli.demokristian

**Këshilli redaktues:**

Kristina Pjetri, *studente*  
 Mark Gjuraj, *aktivist*  
 Vilson Kola, *student*  
 Lush Neziri, *aktivist*  
 Mark Marku, *student*

**Bashkëpunëtorë të jashtëm:**

Hazir Mehmeti, Valentina Pjetri  
 Anita Marku, Majlinda Saliaj  
 Agron Shala, Agim Deda  
 Lush Culaj, Xhenc Bezhi  
 Edvana Gjashta, Zef Ndrecaj


**Përmbajtja:**
**AKTUALITETE**

100 vjetori me revistën "Pelegrin"	3
Promovime librash-takime krijuesish	4
Çfarë kuptimi ka fjala shqiptar?	5
Gjuha-dëshmi e lashtësisë sonë	6
Roli i përkthyeses gjatë këshillimeve	8
Roli i gjuhës amtare në mërgim	9
Sporti na bashkon	10

**FEJTON**

Premtimet për demokraci	11
-------------------------	----

**INFO**

Nga Austria	12
Nga Kosova	14

**OPINIONE**

Fjala jonë	15
Letër nga diaspora	15
Kombi është akti besimi	16
Kosova, pesë vjet pas pavarësisë	17

**INTERVISTA**

Rolanda Limani	18
Fadil Tafili	20

**HISTORI**

Prejardhja e kombi shqiptar	21
Pellazgo-ilirët dhe pasardhësit ...	22
Vjena, vendqëndrimi i H. Prishtinës	23
Faktorët që ndikuan në ...	24
Çeta e Kolë Gojanit	25
Shqiptarët e Australisë	26
Pranvera e Demokracisë	27
Mësuesi i popullit: Ndrecaj Gjoka	28
Eposi i Kreshnikëve	29

**KULTURË**

Lahuta	30
Faqja poetike	31
Vështrim mbi Udhëkryqet Misionesh	32


**SPORT**

LSHFA	33
Klubi i futbollit Lahuta e Malësisë	34
Turneu i shahut në Vjenë	34



**Shkruan: Hazir Mehmeti, mësues dhe gazetar në Vjenë**

## 100 vjetori i pavarësisë me revistën “Pelegrin”



Vjenë, 15 dhjetor 2012: - Krijuesit mërgimtarë nga shumë vende të botës takohen me krijimet e tyre në “Pelegrin”, revistë kjo letrare kulturore e botuar nga Klubi i Shkrimtarëve Shqiptarë në Botë, e cila selinë e ka në Athinë të Greqisë. Kësaj radhe “Pelegrin” dhe krijuesit e saj mërgimtarë anë e kënd globit u bashkuan në vazhden e aktiviteteve të shënimit të Shekullit të Shtetit Shqiptar në Vjenë<sup>1</sup>.

Vjena, si njëra nga qendrat e kulturës evropiane, ku lanë gjurmë shumë krijues arti e shkence nga shqiptarët, duke e kujtuar këtu Aleksandër Moisiu, aktorin e madh me famë botërore i cili me “Hamletin” e tij pushtoi skenat e teatrove. Emri i tij përjetësohet me shoqatën e krijuesve “Aleksandër Moisiu”, krijimet e së cilës kësaj radhe ishin në faqet e “Pelegrin”. Ambasadat shqiptare në Vjenë, vërtetë janë bërë shtëpi e parë e prekjes së ngrohtësisë së vendlindjes, kujdesit dhe dashurisë për mërgimtarin krijues e mall plot.

Kësaj radhe nikoqir i aktivitetit ishte Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Austri dhe personalisht Dr. Vili Minarolli, ambasador, pjesë nga krijimtaria e tij letrare edhe u lexuan, duke e sjellë prezencën e tij artistike aty pranë flamurit kuqezi i cili tani mbanë 100 vite simbol e krenari e shtetit shqiptar. Egin Ceka, këshilltar në Ambasadën e Shqipërisë i përshëndeti të pranishmit në cilësinë e nikoqirit. Me prezencën e tij e nderoi aktivitetin Dr. Sabri Kiqmari, ambasador i Republikës së Kosovës në Austri. Ai në fjalën e tij mes tjerash tha: “Aty ku përcillen vlerat kulturore e letrare të bashkatdhetarëve tanë ne dëshirojmë të jemi prezent. Ambasada e Kosovës, sikur sot kjo e Shqipërisë do ju përkrahim në vazhdimësi”. Nga Ambasada e Maqedonisë në Austri krijuesit dhe mysafirët dashamirë të fjalës së shkruar i përshëndeti diplomati Fitim Nuhiu.

Programin e udhëheqi Edona (Ramadani) Quku, poete. Prezent ishte edhe kryetari i Shoqatës së Mësuesve dhe Prindërve Shqiptarë në Austri, Osman Ademi. Në promovim morën pjesë edhe grupi i veprimtarëve nga Landi i Salzburgut të cilët organizuan dikur ndihmën për Kosovën, ushtrinë e saj, atëherë kur luhej me jetën, të jesh apo të mos jesh. Ata shoqëroheshin nga shkrimtari dhe veprimtari i njohur në Austri, Zef

Ndrecaj. Rreth revistës letrare kulturore “Pelegrin” foli Besim Xhelili, kryetar i shoqatës së krijuesve “Aleksandër Moisiu” në Austri. “Pelegrin” ka jetë që nga viti 2004 dhe është organ i Klubit të Shkrimtarëve Shqiptarë në Botë “Drita”. Njëri nga themeluesit e saj krahas Nase Jani është edhe Dr. Vili Minarolli, ambasador i Shqipërisë në Austri. Redaksia e “Pelegrin”-it është e vendosur në disa shtete dhe pritet që të kemi edhe në Vjenë, si qendër shekullore e krijuesve poetë e letrarë nga radhët e shqiptarëve. Në numrin e nëntëmbëdhjetë, solemn të 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë në “Pelegrin”, prezantohet edhe shoqata e krijuesve “Aleksandër Moisiu” nga Vjena, përmes anëtarëve të saj Besim Xhelili, Anton Marku, Hazir Mehmeti, Amir Jonuzaj, Dan Kosumi, Ragip Dragusha, Zef Ndrecaj, Zaim Toska dhe poetja e re nga Vjena, Edona (Ramadani) Quku.

Në emër të shoqatës “Aleksandër Moisiu” Fadil Tafili,



artist, i dhuroi Ambasadës së Shqipërisë me rastin e Shekullit të Shtetit një pikturë të bukur. Piktura ishte e punuar në një teknikë të veçantë, e gdhendur në pllakë metalike. Fadil Tafili në fjalën e tij përshëndetëse tha se ndihet krenar që sot mund t’i dhuron një nga punimet e tij përfaqësuesit të shtetit shqiptar këtu në Austri. Ai e shpjegoi teknikën e artit të tij të veçantë dhe krejt e re në kontinentin tonë duke theksuar se “unë jam i vetmi që momentalisht punoj në këtë teknikë të re në Evropë, kurse në SHBA janë nëntë artist tjerë. Kjo teknikë ka zgjuar interesim të madh në art, kritikën e artit dhe ndihem i lumtur që edhe ne shqiptarët krahas kombeve tjera këtu në Austri po tregojmë vlera nga kultura e jonë”. Në pikturë paraqiteshin trevat etnike shqiptare dhe figurat madhore historike të kombit tonë.

Në orën letrare të organizuar me këtë rast lexuan krahas krijuesve tjerë edhe poetët Haxhi Morina nga Linci dhe Zef Ndrecaj nga Salzburgu, ndërsa nxënësja Blerita Ismaili u paraqit me një këngë të bukur.

<sup>1</sup> <http://www.youtube.com/watch?v=DFVGDGeo54E&feature=youtu.be>





Shkruan: Ramiz Selimi, Linc/Vjenë

## Promovime librash të shumtë dhe takime krijesish



*Librat e promovuar në Vjenë*

Vjenë, 19 janar 2013: - Hapësirat e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Vjenë janë kthyer në një objekt kulturor për krijuesit dhe artistët shqiptarë në Austri. Ato hapësira ishin të vogla për të pranuar të gjithë krijuesit në promovimin e antologjisë së parë të krijuesve shqiptarë në Austri të titulluar “Illyricum”<sup>2</sup>. Në këtë përrurim në Vjenë, merrnin pjesë, pos autorëve të librave, edhe udhëheqës të organizatave e shoqatave të ndryshme, aktivistë dhe veprimtarë të dalluar të komunitetit, biznesmenë, avokatë, intelektualë, studentë, gazetarë dhe personalitete nga jeta politike, kulturore, e dashamirë të librit.

Prania dhe mbështetja institucionale nga ana e dy ambasadave tona në Austri, e dy ambasadorëve krijues Dr. Vili Minaroli dhe Dr. Sabri Kiqmari, po u jep një vlerë të madhe këtyre organizimeve. Nga Gjermania enkas për këtë promovim kishte udhëtuar kryetari i shoqatës së shkrimtarëve shqiptarë nga ky vend Hasan Qyqalla me bashkëpunëtorët e tij Fran Tanushi dhe Muhamet Luma.

Moderatore e këtij promovimi ishte poetja Edona Quku. Fjalën e hapjes e mbajti kryetari i shoqatës

“Aleksandër Moisiu” Besim Xhelili, i cili falënderoj ambasadën për mbështetjen e vazhdueshme që po u bën krijuesve. Ai po ashtu i uroj krijuesit për promovime të shumta dhe të suksesshme. Ambasadori i Kosovës Dr. Sabri Kiqmari në fjalën e tij vlerësoi lart punën e mirë që po bënte shoqata “Aleksandër Moisiu” nga Vjena me promovimin e vlerave tona kombëtare. Ambasadori i Shqipërisë Dr. Vili Minaroli, ndër të tjara, tha “Deri në kohë kur ne (shtete tona) të krijojmë një qendër kulturore të përbashkët në Austri, ne do hapim dyert e ambasadave çdoherë për krijuesit tanë. Ju sugjeroj, sidomos shoqatës, që të themeloni një çmim shpërblyes për krijuesit më të mirë, për të motivuar edhe më shumë këta krijues”. Kryetari i shoqatës së shkrimtarëve shqiptarë nga Gjermania, Hasan Qyqalla, bëri prezantimin e librit antologjik “Një shekull dritë” me 100 poetë me 100 poezi të përzgjedhura me rastin e shënimit të 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë.

Më pas u kalua në prezantimin e librave të autorëve të ndryshëm. Besim



Xhelili për librin e Anton Markut “Në duet me vetveten” tha se “është një vëllim poetik që trason vlera në një rën anë dhe hulumton modernen në anën tjetër. Libri është përkthyer edhe në gjuhën gjermane dhe është pritur mjaft mirë nga kritikët e letërsisë austriake”. Libri “... dhe vjen një ditë...” nga Dan Kosumi, ishte libri i radhës që u promovua. Është një libër poetik, i cili krijon diskurs në letërsinë e sotme shqipe.

U prezantuan edhe librat “Andrra e lumturueme” nga poeti shkodran Ragip Dragusha. Vargjet e poetit Besim Xhelili “Baladë e ngrirë” i prezantoi redaktori i këtij libri Amir Jonuzaj. Romani i shkrimtari shqiptar me banim në Budapest, Driton Smakaj “Udhëkryqje Misionesh” u tha se ka për tematikë kohën e luftës dhe misioni ka një rrugë të mundimshme dhe të gjatë. Në fund u promovua edhe libri “Shtegtari i largët” me poezi nga Amir Jonuzaj. Ky libër nuk ishte e paraparë të promovohet pasi që priste 18 vite për tu promovua. Recensentë të kësaj vepre kishin qenë Ali Podrimja dhe Ramiz Kelmendi.

Gjithsejtë u promovuan 8 libra të krijuesve nga mërgata shqiptare. Ky organizim si promovim kryesor kishte librin “Illyricum” të shkruar nga 18 autorë dhe krijues shqiptarë në Austri.

<sup>2</sup> <http://youtu.be/3lthHdEriYc>



**Shkruan: Dr. Ina Arapi, Vjenë**

## Çfarë kuptimi ka fjala shqiptar?

Duke qenë se jetojmë në një vend të huaj e përjetojmë më qartë dhe më shpesh se bashkëkombasit tanë në atdhe faktin që emri etnik me të cilin na emërtojnë të huajt është i ndryshëm nga ai me të cilin e emërtojmë ne vetveten. Kështu ne vetveten e quajmë *shqiptarë* që flasim *shqip*, ndërsa për austriakët jemi *Albaner* që flasim *Albanisch*. Deri këtu nuk duhet të habitemi dhe aq shumë sa kohë që edhe fqinji ynë kryesor e quan veten *Deustcher* që flet *Deutsch*, por për të tjerët ai është *gjerman*/angl. *German* që flet *gjermanisht*/angl. *German*. Si shqiptarë habitemi kur mësojmë që ky emërtim është relativisht i ri, sepse në mesjetë edhe ne kishim një tjetër emër etnik që përkonte me emrin etnik që përdornin të huajt për ne, siç ndodh rëndom për shumicën e popujve evropianë. Kështu në mesjetë paraardhësit tanë quheshin *arbën*/*arbër* ose *arbëneshë*/*arbëreshë*, ndërsa gjuha e tyre quhej *shqip* ose *gjuha arbëneshë*/*arbëreshë* dhe vendi i tyre *Árbën*, *Árbëni*.

Pse dhe si ndodhi ky ndryshim? Shumë studiues janë përpjekur t'i gjejnë shpjegimin këtij fenomeni të pazakonshëm në Evropë, por një përgjigje përfundimtare nuk kanë dhënë, ngase edhe dokumentat mungojnë. Në këto kushte te një përfundim i saktë do të na çonte vetëm një *arsyetim i fortë logjik* duke u bazuar në kontekstin historik-shoqëror në të cilin jetoi popullsia, e cila në një periudhë jo fort të largët e pa të arsyeshme të hiqte dorë nga emri i vjetër etnik dhe të krijonte një të ri.

Është e sigurt që emërtimi *shqiptar* lidhet me emërtimin *shqip* që, me sa duket, përdorej prej kohësh për gjuhën, sepse fjalën *shqip* e gjejmë që në librin e parë shqip të shkruar nga Gjon Buzuku në vitin 1555. Kjo do të thotë se *shqiptar* është ai i cili flet gjuhën shqipe, ndërsa *Shqipëri* është vendi ku flitet shqip (dhe jo vendi i shqiptarëve). Më tej kjo do të thotë se pas një periudhe të caktuar që i referohet me sa duket shek. XVIII emri etnik i popullit u lidh pazgjidhshmërisht me gjuhën që fliste ai duke formuar binomet (*gjuhë*) *shqipe* - *shqiptar* dhe (*gjuhë*) *shqipe* - *Shqipëri*. Gjithashtu është i sigurt fakti që kalimi te emrat *shqiptar* dhe *Shqipëri* ndodhi pas pushtimit përfundimtar të trojeve arbërore nga pushtuesit osmanë, sepse ata që u larguan gjatë kohës së rezistencës antiosmane dhe pas saj në vendet përreth e quajnë edhe sot veten *arbëreshë*.

Veç kësaj emërtimet që kishin për bazë fjalën *arbën* përdorshin deri në fillim të shek. XVIII edhe nga autorët e vjetër gegë si Budi, Bardhi e Bogdani. Atëhere përse ndodhi ky ndryshim? Duke iu bashkuar përfundimit të arritur kohët e fundit nga prof. B. Demiraj mendoj se nuk ka dyshim se krijimi dhe përdorimi i një emri të ri etnik lidhet me një moment dramatik në historinë e popullit shqiptar, kur pas pushtimit turk dhe ndryshimeve kolosale që solli ai siç ishin thyerja e unitetit fetar, kthimi i pjesës më të madhe të popullsisë në fenë islame dhe depërtimi i një kulture të re orientale që ndryshonte rrënjësisht nga ajo vendasve, popullsia e kuptoi se gjuha ishte elementi i përbashkët kryesor që duhej dhe mund ta mbante atë të bashkuar. Kështu ajo e vendosi gjuhën në bazë të identitetit të vet duke i konsideruar si të pavlefshme për këtë identitet elementët e tjerë si p. sh. fenë. Në këtë proces ajo shprehu edhe njëherë një prej vetive të saj kryesore që është ndërgjegjia e

fortë gjuhësore dhe vendosmëria që historikisht ka treguar për ta mbrojtur gjuhën e vet nga asimilimet e huaja.


Po sot? Pavarësisht se nuk jemi të ndërgjegjshëm ndodhemi pak a shumë në të njëjtën situatë. Në kushtet e një presioni shumë të madh politik lind pyetja: a do të vazhdojë ta ruajë ajo pjesë e popullsisë që jeton në Kosovë emërtimin *shqiptar* apo do ta riemërtojë veten me emra të tjerë si *kosovar*, *shtet kosovar*, *popullsia kosovare* dhe pse jo edhe *gjuha kosovare*? Koha do ta tregojë. Rolin kryesor do ta luajë si gjithnjë ndërgjegjia gjuhësore, pra fakti se çfarë vendi do t'i japi kjo popullsi gjuhës së vet amtare në togun e interesave të tjera materiale dhe jomateriale dhe sa e çfarë është e gatshme të sakrifikojë ajo.

Ne që jetojmë jashtë nuk mund të jemi pjesë e këtij procesi, por mund të luajmë ndoshta rolin e një shembulli a regullatori. Loja është e hapët, me shumë të papritura dhe shumë interesante jo vetëm për faktorët politikë, por edhe për ata shkencorë.

Shkruan: Shpresa Musaj, MA, Vjenë

## Gjuha-dëshmi e lashtësisë sonë mijërvjeqare

Studim mbi lidhjen pellazgo-iliro-shqiptare mbështetur tek të dhënat gjuhësore



Studimi që keni përpara trajton temën e lidhjes pellazgo-iliro-shqiptare nga këndvështrimi gjuhësor, duke u mbështur në studime të ndryshme të gjuhëtarëve dhe historianëve të huaj, kryesisht të atyre gjermanë, shumë prej të cilëve kanë qënë deri tani të panjohur për publikun shqiptar.

Në studim trajtohet teza e pranuar pothuaj nga të gjithë studiuesit e huaj, që territoret në të cilat banojnë sot grekët kanë qënë fillimisht të banuara nga popullsi të tjera të ndryshme etnikisht prej tyre, të cilët njihen me një emër të përbashkët **Pellazgë**. Sipas tyre pothuaj të GJITHË EMRAT e HYJNIVE TË MITOLOGJISË ANTIKE DHE TË HERONJVE TË POEMAVE HOMERIKE nuk janë emra grekë, por i përkasin gjuhës së popullsisë pellazge ndërsa grekët e ardhur do ta merrnin kulturën pikërisht prej kësaj popullsie.

Për tu vënë në dukje është që edhe Troja është përcaktuar si një qëndër e rëndësishme e ilirizmit. Njëra nga linjat e sunduesve të Trojës ishte fisi i

Dardanëve, vendbanimet e të cilit i takojmë në dy zona të ndryshme, në afërsi të Trojës dhe në Ballkan, në Kosovën e sotme. Prej tyre do të marrë emrin edhe ngushtica e Dardaneleve.

Gjuhëtarët i mbështesin këto përfundime në analizën gjuhësore të emërtimeve gjeografike të antikitetit, të shpërndara në të gjithë territorin e Greqisë, të cilat nuk mund të shpjegohen dot me anë të ligjeve gjuhësore të gjuhës greke. Numri i tyre është kaq i madh, thotë Kretschmer, sa që emërtimet greke pothuaj humbasin në këtë mori.

Emërtimet gjeografike, emrat e lumenjve, të maleve, të vendbanimeve si dhe emrat e fiseve kanë një rëndësi të veçantë për studimet gjuhësore, pasi ato arrijnë të mbijetojnë mijërvjeçarët dhe mbeten në përdorim edhe sikur popullsia e një vendi të ndryshohet disa herë duke u bërë kështu dëshmi e gjuhës dhe etnicitetit të popujve që kanë jetuar në treva të caktuar në një periudhë të caktuar të historisë.

Një pjesë e madhe e këtyre emërtimeve takohen përsëri në Gadishullin Apenin, Itali, pjesa jugore si dhe gjithë bregdeti lindor e të cilit kanë qënë në kohët e hershme të banuara nga fiset ilire të Messapëve, Japigëve, Venetëve, Liburnëve si dhe shumë fise të tjera ilire. Ngjashmëria që emërtimet Italisë tregojnë me emërtimet ilire të Ballkanit dhe me emërtimet e Greqisë paragreke, vendos lidhjen midis fiseve pellazge dhe fiseve ilire, pasardhësit e të cilëve janë shqiptarët e sotëm.

Duke u mbështetur në analizën e emërtimeve gjeografike gjuhëtarët kanë arritur në

përfundimin që vendbanimet e fiseve ilire në një periudhë të hershme të historisë kanë qënë të shtrira në hapësira shumë të gjera të kontinentit Europian, duke filluar nga Azia e Vogël, ishujt e Egjeut dhe në të gjithë Greqinë, duke vazhduar në të gjithë Ballkanin, në Norikum (Austria e sotme), Raetia antike (Zvicera e sotme) Gjermani, Poloni deri në Detin Baltik në Verilindje, Panonien (Hungari), në pjesë të gjera të Gadishullit Apenin, Itali, në perëndim dhe në jugperëndim të Europës ato shtriheshin nga Franca deri në Gadishullin Iberik, Spanjë, Portugali dhe në veri deri në ishullin Britanik, Angli.

### **Një hapësirë me përmasa imponuese, thotë Krahe.**

Në studim është trajtuar edhe një fenomen i veçantë, ngjashmëria që tregojnë disa fjalë të gjermanishtes me fjalët e shqipes së sotme dhe sfondi historik që ka çuar në këto ngjashmëri. Këtu po sjell disa shembuj për të ilustruar këtë ide: **Fjala Tag** m. = ditë, është e ngjashme me fjalën „ag, agoj“, fjala **grüssen** është e ngjashme me fjalën „ngrys“ në shprehjen „si u ngryse?“, fjala **Vertrag** është e ngjashme me fjalën “treg”, **weinen** është e ngjashme me fjalën “vaje, vajet”, **hassen** është e ngjashme me fjalën “hasëm, hasmi” ose me kuptimin “ka haset – ka zili”, **zanken** = zihem, është e ngjashme me fjalën “zënkë, dial. zankë”, fjala **kurz** është e ngjashme me fjalën shkurt, kurt = (sh) kurt, **Rank** – intrigë, është e ngjashme me fjalën rreng, **rar** është e ngjashme me fjalën rrallë (r/l), **rutschen** = rrëshqet, **stürzen** është e ngjashme me fjalën shtyj, **schäkern** është e ngjashme me fjalën shaka, **egal** është e ngjashme me fjalën “gajle“ (kam/s’kam gajle), **verdinen** është e ngjashme me fjalën leverdi (kam leverdi, kam fitim), pjesët përbërëse të të cilave janë plotësisht të ngjashme: verdi (nen) = (le) verdi, **borgen** është e ngjashme me fjalën borxh. Një listë të fjalëve të ngjashme të të dy gjuhëve do ta gjeni në studim.

Kjo tezë është mbështetur në përfundimin që kanë arritur gjuhëtarë të ndryshëm, të cilët kanë pranuar që **Gjermania lindore, jugore dhe veriperndimore, Austria dhe Zvicera si dhe vende të tjera në veri të Danubit deri në Detin Baltik, kanë qënë në një periudhë të hershme të historisë të banuara nga fise ilire. Këtë tezë e mbështesin një numër i madh emërtimeash gjeografike, të cilat janë pranuar si emërtime ilire: p.sh. Kärnten, Imsht, Tulln, Attersee, Attergau, etj.**

Referencat për të gjitha këto ide të paraqitura këtu shkurtimisht do t’i gjeni në këtë studim.

Ky studim është një përpjekje për t’i sjellë nga afër publikut shqiptar mendimin e studiuesve të ndryshëm të huaj si dhe për t’i përcjellë atij fakte deri tani të panjohura në këtë fushë.

Ata që dëshirojnë ta blejnë librin mund të kontaktojnë në adresën: [shpresamusaj@yahoo.de](mailto:shpresamusaj@yahoo.de)





### Shkruan: Edvana Gjashta, Kryetare e Shoqatës “Lëvizja e Gruas Shqiptare” në Linc

Elvana Gjashta lindi në Tiranë me 19 korrik 1974. Shkollimin e përfundoi në qytetin e lindjen. Në vitin 2000 vjen në Austri. Që nga viti 2008 punon në bashkinë e qytetit të Lincit në zyrën e emigracionit. Në të njëjtën kohë është e angazhuar dhe si përkthyes në shumë institucione vendase.

## Roli i përkthyeses gjatë bisedave këshilluese

*‘Kush nuk njeh gjuhë të huaja, nuk di asgjë për gjuhën e tij’* (Johann Wolfgang von Goethe)

Që prej 5 vjetësh, përveç punës time pranë zyrës së emigracionit në bashkinë e Lincit, punoj edhe si përkthyes në gjuhën gjermane, shqipe e italiane në Austrinë e Epërme. Përkthimet mbulojnë një pjesë të konsiderueshme, jo vetëm në fushën ligjore, por edhe shëndetësore dhe sociale. Për mua si përkthyes kjo punë nuk është thjeshtë të jem vetëm interpretese e gjuhës, por një bashkëpunim midis punëtorëve socialë, ekipit mjekësorë dhe klientëve për zgjidhjen sa më mirë të gjendjes në të cilën ndodhen këta persona. Në vitet e fundit kjo temë po bëhet edhe më aktuale në Austri. Përkthyesi/sja luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin e urave midis dy kulturave.

Përgjatë rrugës ndërtimore të urave midis kulturave të ndryshme është e rëndësishme që të gjithë personat e përfshirë të jenë të hapur me njëri-tjetrin, sepse vetëm nëpërmjet mirëkuptimit, si dhe akceptimit mund të arrihet që këto ura të ndërtohen pa pengesa, si dhe të jetësohet një komunikim i lirë midis personave me gjuhë të ndryshme. E rëndësishme është që përkthyeset/ët jo vetëm të zotërojnë gjuhën e huaj, por gjithsesi të kenë edhe aftësi të tjera, si p.sh kompetencat ndër-kulturore. Rol të qenësishëm zënë normat, rregullat dhe sjelljet e personave në momente të ndryshme me kultura të ndryshme. Thelbësore është jo vetëm gjuha si mjet i komunikues, por duhet të merren parasysh edhe faktorët tjerë, si neutraliteti si dhe ruajtja e sekretit profesional. Ata duhet po ashtu të jenë të informuar për ligjet si dhe zbatimin e tyre. Përkthyesit dhe përkthyeset shumë herë marrin një rol të posaçëm si persona të besuar në biseda që konsiderohen të vështira, ose për të zgjidhur problemet e krijuara. Për të zhvilluar një punë sa me më shumë kualitet karakteristikat e një përkthyesi/se janë: njohja e mirë të gjuhës, koncentrimi, pavarësia në punë, rezistenca ndaj stresit, fleksibiliteti, besueshmëria, vendosja e kufijve mes profesionit dhe vete personit, etj. E rëndësishme është që përkthyesi/sja të ketë kompetenca ndër-kulturore dhe nëpërmjet këtyre aftësive të bëjë të mundur që komunikimi në trekëndësh të rrjedhë pa probleme. Përmes këtyre njohurive, të fituara edhe duke marrë pjesë në seminare, dhe po ashtu si ndërmjetës/e të mundësojë që të dy palët, edhe pse nuk flasin të njëjtën gjuhë, të komunikojnë më të lehtë me njëri-tjetrin, duke mos harruar dhe aspektet e tjera si kultura edhe zakonet

*‘Përkthyesi me gojë e ka fjalorin në kokë, ndërsa përkthyesi me shkrim e ka atë mbi tavolinë’* (Johann J. Amkreutz)

Në fushën sociale është i rëndësishëm dallimi mes përkthyesit me gojë dhe atij me shkrim. Në shikim të parë duket që nuk ka ndryshim midis dy përkufizimeve, dhe sikur të dy profesionet luajnë të njëjtin rol gjatë këshillimeve. Por nëse do të shohim nga afër ka diferenca të mjaftueshme midis këtyre dy profesioneve. Përkthyesit/set me shkrim duhet të jenë të talentuar me shkrim, që tekstet e përkthyer të jenë sa më të natyrshme dhe të ndërtuara mirë. Përkthyesit/set me gojë janë persona që fjalën e dhënë e transmetojnë menjëherë nga gjuha aktuale në atë të kërkuar. Kjo shërben që komunikimi të rrjedhë sa më natyrshëm. I gjithë ky proces ndodhë gojarisht dhe quhet “face to face” (fytyrë për fytyrë). Përkthyesit i nevojitet një koncentrim i madh gjatë bisedës dhe po ashtu duhet të bartë edhe ndjenjat e të dy personave në këtë bisedë trekëndëshe. Nuk është e lehtë të gesh personin e duhur si përkthyes dhe ta përfshish atë gjatë bisedës. Në shumë raste vëmendja i kushtohet vetëm gjuhës dhe harrohen detale që janë të rëndësishme, si gjinia, prejardhja, etj. Gjatë formimit të rrjetit të përkthyesëve në organizata të ndryshme sociale shëndetësore dhe ato të emigranteve deri tani këto aspekte nuk merreshin parasysh, sepse e gjithë vëmendja i kushtohet vetëm gjuhës si mjet komunikimi. Kohët e fundit edhe këto institucione e kanë vënë re se këto aspekte me rëndësi të veçantë luajnë rol vendimtar që këshillimi të ketë një rezultat të dëshiruar për të dy palët. Për personat që nuk e zotërojnë gjuhën është shumë e rëndësishme që në fillim të marrin disa informacione të përgjithshme mbi prejardhjen e përkthyesit. Shpeshherë nga personat që kanë nevojë për një përkthyes shtrohen këto pyetje: A do më kuptojë çfarë dua të them? A ka të njëjtën prejardhje si unë? Mund të më kuptojë shumë mirë që të transmetojë emocionet dhe ndjenjat e mia? A është person i besuar? Një rol të posaçëm luan gjinia e përkthyesit/ses. Për shumë persona që vijnë nga sisteme patriarkale dhe nuk e kanë të lehtë të flasin për problemet e tyre me një person të huaj dhe në praninë e një përkthyesi/se, mbi të gjitha femrat, e kanë shumë herë më të vështirë të flasin për ndjenjat e tyre me një mashkull, dhe do të jetë shumë e rëndë nëse përmbajtja e bisedës së përkthyer do të tregohet edhe më tej. Prandaj duhet të merret parasysh kur të angazhohet një përkthyes/se, jo vetëm gjinia po edhe origjina e përkthyesit. *‘Një gjuhë e huaj është për tu pasur zili kur dikush vetëm me një fjalë mund ta përshkruaj, ndërsa të tjerët duhet ta përshkruajnë me më shumë fjalë. Çdo gjuhë ka faktorët pozitivë ose negativë në raport me gjuhën tjetër. Gjuha sjell me vete një pjesë të atmosferës së vendit’* (Johann Wolfgang von Goethe).





### Shkruan: Edona (Ramadani) Quku, Vjenë

U lind në Strugë, më 1 nëntor 1987. Që në moshë të re u largua nga vendlindja dhe migroi në Austri, ku momentalisht studion gjuhën gjermane dhe atë angleze në Universitetin e Vjenës.

## Roli i gjuhës amtare në mërgim

Shumë fëmijëve shqiptarë me vendbanim në Austri apo në shtete tjera të Evropës iu ofrohet mundësia të frekuentojnë vullnetarisht mësimin plotësues të gjuhës së tyre amtare. Duhet të jetë ky një privilegj për ta, pasi kjo jo vetëm që u ndihmon të mësojnë gjuhën e tyre në mënyrë të organizuar, por edhe i mbështet ata në zhvillimin e identitetit të tyre social dhe kulturor.

Rreth kësaj çështjeje dua fillimisht të përmend një argument, ndoshta të shumë prindërve që jetojnë jashtë vendit shqiptar.: -“Fëmija im e di shqipen pasi e flasim në shtëpi. Më e rëndësishme është që ata ta mësojnë gjermanishten sa më shpejtë sepse në tashmë jetojmë këtu”. Është ky një ndër argumentet të cilat i pengojnë fëmijët të mësojnë vlerën e gjuhës së nënës.

Fëmijës në shumë raste nuk i jepet mundësia të mësojë alfabetin e gjuhës amtare në mënyre institucionale dhe shumë më pak i jepet rasti që të mësojë për kulturën dhe vendin e tij në shkollë. Gjuha shqipe në të shumtën e rasteve mësohet vetëm në rrethana familjare ku gjithashtu tashmë është duke u krijuar një gjuhë e përzier me fenomene të ashtuquajtura “code-switching”, ku fjalë të dy gjuhëve ndërrohen (dhe ngatërrohen) vazhdimisht. Në këtë mënyrë krijohet një socializim gjuhësor jo i plotë. I mbetur në mes. Një bilinguizëm në të cilin të dy gjuhët mbeten të pazhvilluara.

Ndaj duhet që fëmijëve t'u krijojmë hapësirë për të folur në gjuhën amtare, të flasim qartë e bukur e të jemi më afër mundësive mbështetëse si ai i mësimi plotësues. Duhet të përkrahim fëmijët që ata mos të vuajnë nga ndjenja e të pasurit një gjuhë të pazhvilluar, gjë e cila ka të bëjë edhe me identitetin e tyre në mërgim.

Prindërit janë ata të cilët duhet t'i bëjnë hapat e parë dhe në mënyrë motivuese t'i ndihmojnë dhe shpjegojnë fëmijëve që mësimi i gjuhës së nënës është i nevojshëm pasi zotërimi i saj është bazë për zotërimin e një gjuhe tjetër.

Mosnjohja e formave elementare të kulturës letrare së shqipes krijon efektin që fëmija të ketë vështirësi edhe në gjuhën gjermane. Gjë që nuk shihet në vitet e para shkollore, por më vonë në aftësitë kognitive dhe arritjet akademike.

Mësimi i gjuhës shqipe nuk duhet të nënkuptohet vetëm si mjet për komunikim, por edhe si faktor për zhvillimin e kompetencës së përgjithshme gjuhësore dhe të zhvillimit të vetëdijes dhe identitetit kulturor. Është

detyrë e prindit t'a ruajë dhe kultivojë identitetin kombëtar, shenjë e së cilës është edhe gjuha amtare. Njohja e saj është një pasuri për vet fëmijën. Po ashtu edhe për shoqërinë.

Duhet të mendojmë për gjeneratat e ardhshme në mërgim, t'a bartim gjuhën dhe vlerën e saj më tej që ajo, në asnjë rast dhe rrethanë të mos harrohet.



### Shkruan: Majlinda Saliq, Linc

Lindi në vitin 1969 në Kukës. Me 1991 diplomoi në degën histori-geografi në Universitetin e Shkencave Shoqërore "Luigj Gurakuqi" në Shkodër. Punoi si mësuese në Tiranë (1991-2003). Në vitin 2003 vjen në Austri. Aktualisht është e angazhuar si punëtoresh sociale në organizatën "Caritas" si dhe vazhdon studimet në "Netzwerk Akademie" në degën e pedagogjisë shoqërore dhe psikologjisë.

## Sporti na bashkon: Të luajmë së bashku-të jetojmë së bashku

Një ndër temat aktuale në Austri e cila po rritet ndjeshëm jo vetëm për ne që jemi migrantë, por edhe për institucionet e ndryshme të cilat kanë të bëjnë me emigracionin apo edhe integrimin në përgjithësi, është pjesëmarrja sa më e gjerë e të huajve në të gjitha fushat dhe sferat e jetës shoqërore austriake. Përpos projekteve me karakter të ndryshëm integruesh dhe kulturor kohët e fundit po i kushtohet një rëndësi shumë e veçantë edhe projekteve me karakter sportiv. Kjo jo për faktin se është një fushë ku nuk është vënë dorë. Përkundrazi, janë të shumta shoqatat sportive si ato të futbollit, basketbollit, notit, skijimit, apo edhe shumë të tjera ku numri i të huajve është në një shifër shumë të kënaqshme.

Këtë radhë bëhet fjalë për vajzat e të rejat të cilat kanë prejardhje të huaj. Është fakt se ky numër është për të dëshiruar apo për të mos thënë ndoshta që janë të shumta dëshirat e këtyre vajzave që duan të merren me sport, por që mundësitë i kanë pothuajse të kufizuara. Ato marrin pjesë aktive në orën e fizkulturës por në aktivitete jashtëshkollore pothuajse jo. Një projekt me titull "Sport Fair bindet-gemeinsam bewegen, zusammen leben" ("sporti na bashkon, të lëvizim së bashku, të jetojmë së bashku") pasqyron më tepër veprimtarinë ose më mirë të themi punën që po bën ASKÖ Oberösterreich në bashkëpunim me Magistrat Wiener Neustadt për të ngjallur sa më shumë interesin e këtyre vajzave, të cilat të kenë mundësi që nëpërmjet trajnerëve të sporteve të ndryshme të mbledhin vajza të moshës 12-15 vjeçare me kombësi e përkatësi të ndryshme fetare që të lëvizin së bashku, të luajnë e të jetojnë së bashku, duke treguar kështu se janë pjesë e kësaj shoqërie e cila na përket dhe neve, e aq më tepër fëmijëve e të rinjve tanë. Të rëndësishme në këtë aktivitet janë prirjet e preferencat e këtyre vajzave në ato sporte ku ato duan të luajnë: volejbolli, kërcim, atletikë, skijim e shumë fusha të tjera sportive për të cilat ato shprehin interesim, por për arsye të ndryshme nuk kanë mundësi t'i ushtrojnë në mënyrë private. Qëllimi i këtij projekti është që nëpërmjet potencialit që jep sporti si një instancë për integrim si dhe për shkëmbimin ndër-kulturor që sjell ky bashkëpunim ndërmjet vajzave me kombësi të ndryshme, si dhe nëpërmjet kontakteve që mundëson sporti vajzat e kësaj grup-moshe të njihen me veprimtari të shumta sportive.

Përmes funksionit që ka sporti si qëllim tjetër është dhe rritja e vetëdijes dhe e bashkëpunimit në grup ndërmjet tyre. Kjo do të mundësohet në bashkëpunim me shkollat 8-vjeçare apo edhe me qendrat rinore, numri i të cilave në këtë qytet është mjaft i madh.

Natyrisht që ky projekt ofron mundësinë edhe për shoqatat e ndryshme sportive për të pasur sa më shumë pjesëmarrës. Një objektiv tjetër, që është edhe më afatgjatë, është që të huajt që jetojnë në Linc nëpërmjet këtyre shoqatave të integrohen sa më shumë në një sektor të ri të jetës sociale. Një aspekt pozitiv i këtij projekti është që nëpërmjet këtyre ofertave vajzat të njihen e të integrohen më mirë në fushën sociale ku ato jetojnë. Projekti ju krijon këtyre vajzave mundësinë që të njohin vendin të cilin ato jetojnë si dhe traditat sportive të tij. Po kështu një aspekt i rëndësishëm është lidhja më e ngushtë ndërmjet shkollave dhe shoqatave sportive.

Synim tjetër është pjesëmarrja aktive e këtyre vajzave në sport për një kohë sa më të gjatë për të zbuluar pse jo edhe talente të reja në fushat sportive, si dhe për të sjellë brezin e ri në një formë sa më të mirë shëndetësore e sportive (pasi në vitet e fundit për shkak të digjitalizimit të jetës shoqërore sporti është lënë nga kjo gjeneratë pothuajse pas dore). Për realizimin e këtij projekti kërkohej një koordinator dhe pedagogje me prejardhje të huaj si dhe me përvojë në fushën e migrantëve që do njihin edhe kulturën, jetën sociale, zakonet dhe mënyrën e jetesës së asaj pjese që e quajnë emigrantë. Unë bëra kërkesën dhe e pata privilegjin të zgjidhesha. Në këtë pikë u ndjeva krenare për prejardhjen time, e cila pse jo shpesh na ka bërë të jemi të ndrojtur kur vinte puna për të kërkuar punë. Mu dha përgjegjësia për të koordinuar këtë projekt në qytetin e Lincit në disa shkolla. Jam tërësisht e angazhuar dhe e interesuar që ky projekt të zbatohet sa më mirë për faktin se gjithmonë kam kërkuar që vajzat, të rejat, gratë e nënat me prejardhje të huaj të jenë pjesë e pandarë e kësaj shoqërie, me gjithë përvojën e tyre, përpjekjet që bëjnë ato që fëmijët e tyre të kenë një të ardhme më të mirë se ajo që patën ato. E ky fakt nuk është për tu lënë aspak pas dore. Meqenëse bëj pjesë në këshillin drejtues të organizatës së grave të Lincit e di sa e rëndësishme dhe sa e domosdoshme është që vajzat tona të jenë aktive, duke pasur parasysh këtu edhe mundësitë e ofertat që shoqata qeveritare e joqeveritare ndihmojnë në integrimin e migrantëve për tu bërë edhe ata një pjesë e shkolluar apo edhe e mirë integruar në shoqëri. Është fakt që jo vetëm të marrim e të përfitojmë nga këto oferta që na ofrohen, por me eksperiencën e vendeve nga ku vijmë, me talentet e reja që ne kemi, të kontribuojmë edhe ne në sportin austriak duke e bërë atë pjesë të pandarë të jetës tonë. Prandaj me dëshirën e mirë për të ecur përpara ju uroj të gjitha vajzave mirëseardhje e një rrugëtim të mbarë në projektin e ri: Sporti na bashkon, të lëvizim së bashku, të jetojmë së bashku.

## Fejton aktual



**Shkruan: Mirash Ndrejaj, Kryetari i BD të PSHDK në Zvicër**

### Premtimet për demokraci janë të mekta

Ky është titulli i këtij vështrimi që do t'i dedikohet përvjetorit të pestë të shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Ai është marrë nga një thënje nga i madhi Ismail Kadare, i cili pikërisht në muajn tetor të vitit 1990 e tha nga Parisi. Ky ishte një mesazh që i drejtohej pushtetit të asaj kohe në Shqipëri. Po i njëjti mesazh do të ishte i përkryer dhe shumë i përshtatshëm për pushtetarët e Kosovës edhe tani kur kanë kaluar plot 23 vite. Festa e pavarësisë, që padyshim është ndër datat më të rëndësishme të kombit shqiptar, është e eklipsuar nga zhvillimet negative politiko-ekonomike që po e përcjellin Kosovën. Në vend të demokratizimit, të respektimit të ligjit dhe të luftimit të krimit dhe korrupsionit, në Kosovë ka nisur të ngrëjë kokë fryma e dogmatizmit dhe vetëgjyqësisë, e cila rrjedhimisht katalizon një klimë të përgjithshme urrejtje dhe pasigurie. Duke mos pasur një kohezion në qëndrimin politik, qeveria vazhdon të dërgoj mesazhe të padëshifrueshme dhe kontradiktore drejt komunitetit vendas dhe atij ndërkombëtar. Të nderuar lexues, jam më se i vetëdijshëm se shkrimet e kësaj natyre (kritike) po na bezdisin të gjithëve. Por, është e pamundur dhe e papranushme që të ndalemi së shkruari e kritikuari për aq kohë sa situata vazhdon të jetë kjo që është në Kosovë. Jo që nuk pretendoj, por as do orvatem që të jap ndonjë lajm të ri në këtë shkrim. Thjeshtë kjo është një klithje, si shumë e shumë të tjera, që zakonisht kapërdihen pa lënë asnjë gjurmë në sedër të atyre që vërtet nuk ju ka mbetur as edhe një fije morali njerëzor, e lëre më politik.

Në Kosovë asgjë më nuk përbën LAJM: aferat e përditshme korruptive nuk janë lajm. Po të ishin lajm atëherë dikush do jepte përgjegjësi. Shtatëfishimi i rasteve të tregtisë me drogë nuk është lajm nga se kjo tani është krejtësisht e zakonshme në Kosovë. Skandali i pasaportave nuk është lajm. Po të ishte i tillë do e trondiste dikë. Polici shet radiolidhjen dhe jelekun anti-plumb. Edhe ky nuk konsiderohet lajm. Vetvrasjet e dyshimta përsëri nuk përmbëjnë lajm nga se edhe kjo është dukuri që korrespondon me ato që u thanë më lartë.

Unë personalisht LAJM do e konsideroja raportin e Komisionit European për liberalizimin e vizave. Ndonëse me përmbajtjen e tij tmerrësisht negative është i njoftuar i gjithë opinioni. Edhe pse i formuluar me një gjuhë të kujdesshme politike, në esencë ai ripërsëriste të njëjtat kërkesa dhe rekomandime që janë bërë tash e pesë vjetë. Ndër të tjera në raport thuhej: “Mungon vullneti politik për të pasur gjyqësor të pavarur. Lufta gjoja e shpallur kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar rezultoi të jetë fare anemike dhe krejtësisht sipërfaqësore. Zhvillim ekonomik vazhdon të jetë në shkallë tepër të vogël ose fare të papërfillshme, etj”. Në vend që të impenjohemi dhe të vetdijsohemi, kryeministri i vendit gjatë komentimit që i bëri raportit tha se, fajtor për të gjitha është Bashkimi Evropian. Çfarë ironie, o Zot! Vazhdojmë të fajsojmë Evropën për të zezat e të palarat tona.

Lajm sa i hidhur aq edhe i bezdisshëm ishte “historia e përgjimeve” që ju bë “bossave” të pushtetit në Kosovë. Në vend që të turpërohen dhe të kërkojnë falje publike, duke e përcjell me dorëheqje të parevokueshme, ata fajësonin të tjerët që po zbulonin fytyrën e ndyrë të pushtetarëve.

Rudolf Gruber nga Vjena shkruan “Kosova pas pesë vite pavarësi ka pak arsye për të festuar. Qeveria në Prishtinë nuk është në gjendje që të ndërtojë një shtet ligjor. Kryeministri Thaçi me shokët e tij qeverisin në një sistem

klanor, duke kontrolluar gjithçka që ka të bëjë me pushtetin dhe duke shëndrruar demokracinë në një fasadë. Çdo i dyti qytetar është i papunë edhe pse asnjë shtet në botë nuk ka marrë më shumë ndihma financiare se sa Kosova. Që nga viti 1999 e deri në vitin 2007 BE dhe SHBA kanë dhënë 3.5 miliardë euro për ruajtjen e paqes dhe zhvillimit. Lajm tjetër që vlen të përmendet është edhe themelimi i partisë së dytë islamiste. E para ishte Partija e Drejtësisë, kryetari i së cilës është Ferid Agani, ndërsa e dyta (në themelim e sipër) është partia e Fuad Ramiqit. Se sa do të jenë të favorshme ose të dëmshme për Kosovën në arritjet e proceseve integruese mbetet të shihet.

Zymtësinë e manifestimit e thellon edhe më tepër kompleksiteti i krijuar nga përfaqësuesit e institucioneve më të larta shtetërore me rastin e vizitave, respektivisht homazheve që u bënë pranë heronjve dhe familjeve të tyre. Dikush bëri homazhe pranë varrit të Presidentit Historik të Kosovës, por nuk takoj familjen Jashari. Tjetri vizitoj familjen Jashari, por jo dhe varrin e Presidentit, duke krijuar kështu një pamje sa të dhimshme aq edhe mjeruese, duke lënduar me “hujet dhe teket” e tyre patologjike krypto-komuniste ndjenjat e qytetarëve që janë mishruar me personalitetin e Presidentit Historik si dhe me madhësinë e Komandatit Legjendar.

Për mua personalisht, data edhe dita që është për të festuar mbetet dita kur forcat e NATO bashkë me UÇK çliruan Kosovën.

Duke shpresuar në një të ardhme më të ndritur dhe më dinjitoze duke besuar në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme, gëzuar pavarësinë!



## Blic Info nga Austria

### nëntor-dhjetor 2012: Shënohet 100 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë



Nalënit shqiptarë nga Austria e Epërme në shfaqjen teatrale

Në kuadër të shënimit të 100 vjetorit të Pavarësisë dhe Ditës së Flamurit, në mërgatën shqiptare në Austri të Epërme u organizuan një varg aktivitete. Me këtë rast vetëm në Linc u organizuan katër manifestime, pastaj në Alkooven nga Shoqata “Anadrini”, në Vöklabruck nga Shoqata “Iliria”, në Gmunden nga Shoqata “Bashkimi”. Një manifestim shumë inkurajues dhe me nivel shpresëdhënës për organizimin e mërgatës sonë në perëndim ishte edhe ai që u mbajt në “Rathaus” të Linc-it, që u organizua nga shoqata “Kosova”. Ajo që ishte mbresëlënëse dhe mjaft mirë e përgatitur ishte teatri i luajtur nga nxënësit e mësueses Linda Lilaj në shpalljen e pavarësisë. Nxënësit luajtën ngjarjet e vitit 1912 me mjaft mjeshtri.

### 4 dhjetor 2012: Simpozium në Vjenë nga Akademia Austriake për Paqe



Me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, në ambientet e Akademisë Diplomatike të Vjenës u mbajt simpozium me temën “100 vjet shteti Shqiptar”. Synimi ishte që të prezantohej Shqipëria dhe shqiptarët, përfshi këtu edhe komunitetin tonë në Austri. Simpoziumi kushtuar Shqipërisë, përpos historisë tonë dhe sakrificave, përfshinte edhe histori shqiptaro-austriake të njohur, si ajo për Habsburgët, Ministrin e jashtëm Berthold e deri të ndihma ushtarake e oficerit z. Hermann von Kirchner, që në ushtrinë e mbretit Zog në mënyrë aktive nga viti 1928-1939 ndihmoi ushtrinë në organizim. Mysafirët i përshëndeti kryetari i kësaj organizate Ing. MMag. Günther Rosenitz.

### 5 dhjetor 2013: Promovohet libri për piktorin akademik Luan Mulliqi



Promovimi i librit monografik “Mulliqi-një skulptor i madh” i shkruar nga profesori i njohur vjenez Johann Günther, në gjermanisht dhe shqip, u bë në një sallë të bukur vjenezë të Qendrës Ndërkombëtare e përkrahur nga Raiffeisen Bank. Organizator të promovimit dhe ekspozitës me skulptura të Luan Mulliqit ishte Ambasada e Republikës së Kosovës në Austri, Galerie KOKO, Raiffeisen Bank etj. I pari përshëndeti nikoqiri i mbrëmjes, Dr. Herbert Stepic, udhëheqës i Raiffeisen Bank për sektorin jashtë Austrisë i cili uroj artistit tonë të madh qëndrim të këndshëm dhe sukses promovimit të librit me vlerë rreth skulptorit të njohur Luan Mulliqi. Mysafir i mbrëmjes ishte edhe Prof. Dr. Theodor Kanitzer, Presidenti Ndërkombëtar për Chopingesellschaft.

### 6 dhjetor 2012: Në Vjenë hapet ekspozita e Luan Mullit



Në galerinë “Koko” në Vjenë, në një ceremoni solemne është bërë hapja e ekspozitës së veprave të skulptorit të njohur kosovar Luan Mulliqi. Njëzet skulptura në bronz nga cikli i tij “Balerinat” kanë udhëtuar për në qytetin austriak, për të zënë vend në hapësirën e kësaj galerie. Luan Mulliqi deri tash ka hapur ekspozita personale në Galerinë “Renatra” të Chikagos më 1992, dy vjet më vonë në “Artcounter Gallery” të Dallasit të ShBA-së, ndërsa në vitin 1995 në “Gallery Art 54” në New York. Në vitin 2008, nikoqiri i veprave të tij ka qenë Galeria e Arteve e Kosovës, ku për dy mandate ka qenë drejtor. Këtë vit ai ka ekspozuar në galerinë “MK” të Tiranës. Ka marrë pjesë edhe në 12 ekspozita kolektive ndërkombëtare, në Kroaci, Holandë, Austri, Kanada, Japoni, Itali, ShBA, Gjermani, Maqedoni e Francë.

### 15 shkurt 2013: Ekspozitë për shkatërrimin e trashëgimisë kulturore në Kosovë gjatë luftës së fundit



Shkatërrimi dhe rrënimi i monumenteve kulturore është fenomen që rregullisht i prinë, shkon krahas ose i pason tragjeditë e mëdha njerëzore. Kjo praktikë e shkatërrimit të monumenteve të arkitekturës, të artit, të kulturës, objekteve historike e fetare, është zbatuar edhe gjatë luftërave të fundit...Në shënimin e pese vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, krahas gëzimit dhe krenarisë, ofrohen edhe episode të barbarisë serbe ndaj njeriut të pafajshëm, objektet e kultit, historike, të kulturës, sportit, më rëndësi të veçanta. E tillë është dhe ekspozita “Shkatërrimet e trashëgimisë kulturore në Kosovë 1998/99“. Kjo ekspozitë në Vjenë u hap nën organizimin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës nga Prishtina.

### shkurt-mars 2013: Koncerte për nder të pesë vjetorit të Pavarësisë së Kosovës



Pas shënimeve në mënyrë dinjitoze të një shekulli shtet të Shqipërisë, edhe këtë vit shoqata të ndryshme shqiptare në Austri kishin përgaditur programe të larmishme festive për të shënuar 17 shkurtin-ditën e shpalljes së deklaratës së Pavarësisë së Kosovës. Kësaj radhe, në këtë aspekt duhet veçuar shoqatat “17 shkurti” nga Badeni, “2 korriku” nga Wiener Neustadt, “12 qershori” nga Vjena, “Kosova” nga Radstadt, “Bashkimi” nga Graci, ”Dardania” nga Linci, por dhe shoqata të tjera në Sankt Pölten, Innsbruck, etj. Edhe këtë herë entuziastët e tyre kishin përgaditur programe të larmishëm me recitime, këngë dhe valle me motive nga të gjitha trojet etnike shqiptare.

### 16 mars 2013: Orë poetike në Grac



Shoqata integruese, humanitare e kulturore “Stublla” nga Graci dhe shoqata kulturore “Aleksandër Moisiu” me seli në Vjenë organizuan një orë poetike e cila do shënohet në kronologjinë e re të aktiviteteve kulturore të mërgimtarëve krijues. Në këtë aktivitet morën pjesë krijues nga Linci, Vjena, Graci, etj. Ora letrare u përcoll me melodi në piano të luajtur me mjeshtri nga instrumentistja nga Anglia L Amra Ford. Recitimet filluan me autorin Arif Kryeziun, i cili lexoi poezinë “Fara”. Mjaft mbresëlënëse ishin recitimet në të dy gjuhët i përcjellë me piano nga austriaku, Dr. Kurt Gostentschnigg, mik i shqiptarëve. Në pjesën e dytë të programit poezitë e tyre i deklamuan anëtarët e shoqatës kulturore “Aleksandër Moisiu” nga Vjena.

### 21 mars 2013: Ekspozitë në Vjenë e skulptorit të njohur Destan Gashi



Skulptori kosovar që jeton dhe vepron në Vjenë, Destan Gashi, u prezantua para publikut vjenez me ekspozitën personale “Legjenda e Rozafës”, me njëzet skulptura prej mermeri. Fjalën e hapjes e mbajti profesori Johan Gunther. Artdashësit vjenez e njohin artistin tonë prej vitesh pasi që ai edhe më herët ka hapur ekspozita të ndryshme në kryeqytetin austriak, por edhe në qytete tjera të Austrisë dhe të vendeve tjera evropiane. Skulpturat e tij kanë një tematikë që e lidhin me origjinën e tij. E tillë është edhe ekspozita me titull “Legjenda e Rozafës dhe histori të tjera në gurë” e Destan Gashi. Ekspozita u çel në galerinë Artefakt në Vjenë dhe do të qëndrojë e hapur deri më 11 prill.

**Info nga Kosova**

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosovo*

**Ministria e Diasporës – Ministarstvo za Dijasporu – Ministry of Diaspora**

---

**Ftesë publike**

Propozime për çmimet që i ndan Ministria e Diasporës

Ministria e Diasporës, në mbështetje të Ligjit të Diasporës dhe Mërgatës së Kosovës, si dhe Rregullores nr.01/2012 për kriteret dhe mënyrën e ndarjes së çmimit vjetor të diasporës dhe mërgatës ose mërgimtarin më të suksesshëm të vitit, ndan çmimin për mërgimtarin ose grupin më të suksesshëm gjatë vitit 2013 në këto fusha:

1. Veprimtari humanitare;
2. Kontribut të veçantë për shtetin e Kosovës ose për diasporën dhe mërgatën;
3. Arsim, shkencë ose teknologji;
4. Kulturë, sport; dhe
5. Biznes.

Për kontribut të veçantë jetësor në fushat e lartcekura jepet çmimi post mortem.

Ministria e Diasporës u bën ftesë publike të gjitha institucioneve shtetërore, OJQ-ve të ndryshme dhe grupeve të qytetarëve si në vend, po ashtu edhe pjesëtarëve dhe grupeve të diasporës sonë që t'i bëjnë propozimet e tyre për dhënien e çmimit.

Çmimi nuk ka vlerë monetare, por dëshmon vlerësimin e jashtëzakonshëm të Ministrisë së Diasporës për mërgimtarin, i cili me veprimtarinë e tij ka kontribuar në promovimin, ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, kulturor, gjuhësor, arsimor, si dhe të vlerave të përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Propozimet duhet të dorëzohen në zyrat e Ministrisë së Diasporës, më së voni deri më 15 qershor 2013.

Ato duhet të shoqërohen me biografi dhe dokumente, dëshmi dhe vlerësime të nevojshme të veprimtarisë së subjektit të propozuar.

Adresa:

Ministria e Diasporës - Ministry of Diaspora

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", ish-ndërtesa e partive politike, 10000, Prishtinë

Republika e Kosovës

E-Mail: [info.med@rks-gov.net](mailto:info.med@rks-gov.net)

Tel: 038 200 17 006

038 200 17 022



**OPINIONE: Fjala jonë****Promovohet koncept-ideja për themelimin e grupit të debatit “Forumi”**

*Javëve të kaluara në mesin e veprimtarëve në Austri është duke u diskutuar një iniciativë e re. Në vijim do të sjellim elementet kryesore të saj.*

Supozohet se në Austri ka më se 60 000 shqiptarë (30 000 nënshtrëtos kosovarë, 20 000 nga Maqedonia, 5 000 nga Lugina e Preshevës dhe rreth 5 000 nga Shqipëria). Në mesin e tyre ka intelektualë, aktivistë, studentë dhe punëtorë. Komunikimi mes shqiptarëve si dhe integrimi dhe përfaqësimi i tyre individual dhe kolektiv në jetën shoqërore dhe politike në Austri është ende në nivel të ulët. Një ndër shkaqet e kësaj dukurie është edhe mungesa e njohjes dhe debatit mes tyre. Kjo për pasojë ngadalëson avancimin e rolit të shqiptarëve në Austri.

**Qëllimi:** Promovimi i komunitetit shqiptar në Austri

**Objektiva:** Krijimi i një mekanizimi konkret i cili do të adresojë dhe elaborojë sfidat me të cilat ballafaqohet komuniteti shqiptar në Austri, dhe do të dalë me propozime konkrete për përmirësimin e gjendjes aktuale.

**Aktivitetet:** Themelimi i klubit të debatit “Forumi Shqiptar në Austri”.

**Pjesëmarrësit:** 20-25 persona të përzgjedhur dhe të dëshmuar si intelektualë, aktivistë, iniciues dhe bartës të proceseve shoqërore dhe integruese në Vjenë dhe më

gjërë. Do t'i kushtohet kujdes përfaqësimit regjional, gjinor dhe fetar. Takimet do të mbaheshin një herë në dy muaj në një vend të caktuar dhe të mbyllur për publikun. Ato do të drejtoheshin nga një moderator/e. Procesi do të dokumentohej me anë të procesverbaleve, listës së pjesëmarrësve, foto dhe video xhirimeve si dhe shpërndarjes dhe postimeve të rezultateve në platforma elektronike dhe listën e e-mail-ave. Në varësi nga tema që trajtohet klubi mund të ftojë edhe mysafirë/ligjërues të jashtëm.

**Temat:**

- Koordinimi i aktiviteteve mes shoqatave dhe grupeve tjera të shqiptarëve në Austri;
- Integrimi i studenteve në jetën shoqërore;
- Ngrija e vetëdijes për mësimin plotësues në gjuhën shqipe;
- Avancimi i rolit të femrës shqiptare;
- Promovimi i bashkëpunimit mes liderëve dhe komuniteteve fetare shqiptare;
- Përfaqësimi i shqiptarëve në mediat vendase (gazeta, radio, TV, intervista, etj);
- Përkrahja e kandidatëve shqiptar në zgjedhjet e ardhshme në Austri, etj.

**Rezultatet e pritura:** Përmirësimi i interaksionit mes shqiptarëve në Austri dhe avancimi i rolit të tyre në shoqërinë vendase.

**Letër nga diaspora****Komunikimi mes shqiptarëve në mërgim**

Miku im në Prishtinë!

Në Vjenë para pak ditësh u mbajt një referendum për mbështetjen e qytetarëve që ky qytet të konkurojë për të marrë përsipër organizimin e lojrave olimpike në vitin 2028. Në këtë kohë në Kosovë sporti po vazhdon të mbetet nën hijen e politikës dhe mungesës se përkrahjes institucionale. Një gjeneratë sportistësh e humbëm. E vjenezët po mendojnë tash për gjeneratën e ardhshme. Pas 25 viteve.

Kësaj radhe kam vendosur që rreshtat në vijim t'i shkruaj në gegnishten kosovare. E di se do më kuptosh ...Ka qe disa vjet që po rroj e po baj gjumin në Vjenë, dhe t'tham t'drejtën, menoj se te njerëzit tanë këtu mungon shumë-shumë kultura e komunikimit. Këtu bre vlla, ma merr mendja mue, nëse dikush t'qon një informacion, ftesë a thirrje (me letër, e-mail apo sms) duhet me ditë se dërguesit i ka marrë pak kohë për më shkruet tekstin dhe que ftesën. Besa dhe pak harxhim, po. Këtu bre burrë as qe po u lodhshin as një OK me dy shkronja me ta kthye, se për ma shumë mos prit. Veç ne ju japësh pare. Kshtu që ti bahesh vesvese a e ka marrë a jo miku ftesën. Atherë t'duhet me e konfirmue. E me e ba kta duhet me e thirrë tash ti atë dostin në telefon, e besa mund ban vaki (e ban shpesh) që as që ta qon telefonin se .. as që lodhet bile. Po bani vaki e i thirri shefi (austriaku) bien n'hall, n'stres e deri n'panikë e me një qind droje e tutë i përgjigjen n'vend tuj kërkun një mijë e një qind herë falje pa jua lyp kta kurkush. Masanej marrin një hap qetësimi e e qojnë teposhtë me shumë gota ujë. Për ma shumë, intelektualët dhe biz(nis)men-at ishin edhe ma t' lodhtë se të tjerët në këtë punë. Pa pikë

respekti. Kësaj, në vendin prej kah unë vij, i thojnë zero (0) kulturë. Nuk lodhen a i kë thirrë a jo, a i ke nderue me ftesë a jo. Se për të falenderue, hiq se hiq. Duket se fjala tu rritë ndera nuk gjendet në fjalorin e tyne. Boll të përgjuntë mund të jenë në Kosovë, por kshtu nuk bajnë. Nësë nuk kanë kredit në telefon, bile ta bajnë një zile me të ba me dije se e kanë marrë porosinë. Eh ... kjo për mue asht nivel shumë i ulët i komunikimit. Shumë për nder do ja kisha ditë atij që e merr një info prej meje të përgjigjet me po, jo, ma vonë, s'kam kohë, s'kam interesim, mos më qo ma kësi informacioni e të ngjashme. Por as këtë nuk e marrin mundin me e ba. Kjo, menoj unë, nuk asht hiq njerëzore, kolegjiale a miqësore.

Unë nuk po arrij të pajtohem me këtë “Mozallah-fenomen”. E ti?

## OPINIONE:

**Shkruan: Ndue Ukaj**

Ndue Ukaj, shkrimtar, kritik i letërsisë dhe publicist, u lindi në vitin 1977 në Stubëll të Epërme të Vitisë. Ka kryer studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në fakultetin e filologjisë në Universitetin e Prishtinës, ku ka ndjekur edhe studimet e magjistraturës. Një kohë, ka jetuar në Suedi, ku ka ndjekur kurse të gjuhës dhe kulturës suedeze. Ka qenë anëtar i disa redaksive letrare dhe gjithashtu anëtar i disa manifestimeve kulturore. Po ashtu ka qenë editor i revistës për art, kulturë e shoqëri "Identiteti" që është botuar në Prishtinë. Është i përfshirë në disa antologji të poezisë shqipe, brenda dhe jashtë vendit. Poezitë dhe tekstet e tij janë përkthyer në anglisht, rumanisht, spanjisht, italisht dhe suedisht dhe është prezantuar nëpër shumë revista ndërkombëtare. Është autor librash me poezi dhe studime letrare. Ndërsa libri "Godë nuk vjen", u laureua me çmimin kombëtar "Azem Shkreli" për librin më të mirë të botuar me poezi në vitin 2010 në Kosovë. Ndërkaq në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë, "Ditët e Naimit", u laureua me çmimin për poezinë më të mirë.

**Kombi është akt besimi**

(pjesa e parë)

Çfarë do të thotë të jesh pjesëtar i një kombi? E në këtë aspekt, çfarë do të thotë të jesh shqiptar? Një shpjegim domethënës, për pyetjet e më sipërme, gjithmonë sfiduese për personin, por edhe për bashkësinë njerëzore, e jep shkrimtari erudit, Jorge Luis Borges, te tregimi *Ulrika* në formën e një dialogu konciz. *Ajo më pyeti e menduar: Ç'është do të thotë të jesh kolumbian? -Nuk e di, -iu përgjigj. -Është një akt besimi.*

Kombi është një akt besimi. Asgjë ma shumë e as më pak. Pjesëtarët e një kombi, bashkohen rreth idealeve të veta, duke krijuar kulturën e përbashkët dhe kështu duke e shndërruar kombin në një akt besimi, rreth së cilit rrinë të bashkuar të gjithë pjesëtarët e tij. Vetëm duke besuar te e kaluar e tij, (që është traditë e përbashkët), pastaj te ambiciet e tij, e sidomos te gjuha dhe kultura, pjesëtarët e një shoqërie e ndjejnë kombin si një akt besimi dhe krijojnë kohezion e harmoni të brendshme. Pikërisht për këto arsye, shumë njohës të çështjeve shoqërore, mbrojnë idenë se kombet janë ma shumë unitet gjuhësore dhe kulturore, sesa unitet racore.

Nga kjo që thamë, del se kombin e ushqejnë marrëdhëniet e brendshme strukturore, që janë të fuqizuara sidomos nga kultura dhe gjuha, si shtyllat fundamentale mbi të cilat ngrihet dhe mbahet kombi. Këto elemente fundamentale, krijojnë heronjtë e një kombi, figurat eminente dhe etërit e tij, tek të cilat besojnë pjesëtarët e kombit, sidomos në çaste të vështira. Në këtë mënyrë, krijohet ndjenja e besimit dhe kështu kombi bëhet një akt besimi që vetvetiu i shuan dallimet e mundshme brenda vetes. Për shqiptarët, kombi a është akt besimi? Çfarë do të thotë të jesh shqiptar, sot, në këto realitet të reja gjeopolitike që janë krijuar sidomos në dy dekadat e fundit? A kanë shqiptarët përgjigje unike për këto pyetje esenciale?

Po ta kërkonim një përgjigje në këtë pyetje, ajo do të varioje dhe do të varej nga kategorizimet që ekzistojnë brenda kombit. Kohezioni i brendshëm, te ne është prekur pikërisht në kohën kur shqiptarët jetojnë më të lirë se kurrë më parë. Në këtë kontekst, përgjigjen sigurisht s'e jep të njëjtë ai që e ndjen veten brenda identitetit evropian të shqiptarëve, në raport me atë që s'e ndjen. Për më tepër, kjo përgjigje vjen e komplikohet, nëse merren për bazë figurat kryesore kombëtare, etërit e kombit, rreth të cilëve kohëve të fundit janë shfaqur jo pak dallime. Këto dalles,

shpeshherë ngrehin pikëpyetje sfiduese para shqiptarëve. E një nga ato sigurisht është edhe pyetja, nëse është kombi ynë, një akt besimi, rreth të cilit ne ushqejmë ndjenjat e përbashkëta të përkatësisë apo kombi është një arenë ku ne vringëllojmë shpatat e ndarjeve?

Këto pyetje të shumta, natyrisht kërkojnë analiza dhe interpretime të shumta e nga dije të ndryshme. Një gjë është më se e sigurt. Në këto pyetje, shqiptarët s'kanë qëndrime unike dhe kjo duhet ta shqetësojë çdo kënd që merret me çështje të kombit. Kjo sidomos duhet t'i shqetësojë elitat (nëse kanë mbetë të tilla) dhe edukatorët e këtij kombi. Këto dilema, vazhdojnë ta rëndojnë jetën tonë kombëtare, sidomos viteve të fundit, prej kur brenda nesh kanë filluar të rihapen debate për identitetin kombëtar shqiptar dhe dilemat nëse ai është unik apo i fragmentuar. Ndërkaq, këto debate, kanë marrë kahe më dëshpëruese, sidomos pas shfaqjes së një fryme çoroditëse neootomane në jetën tonë kombëtar. Kjo frymë, e cila së pari është stimuluar nga qarqe turke, me kohë zuri vend te disa pseudo intelektualë shqiptarë, të përkratur po ashtu nga disa pseudo historianë dhe në këtë mënyrë është ngritur mjerisht deri në nivelet e larta qeveritare.

Debatet për identitetin kombëtar dhe përkatësinë civilizuese të shqiptarëve, kanë rishfaqur prirje dhe orientime të ndryshme brenda jetës sonë kombëtare. Pikërisht këto debate, kanë stimuluar një klub të strehesave, siç i quan Ismail Kadare, ta çmitizojnë figurën e heroit kombëtar, Gjergj Kastriotin e Nënë Terezës. E sulmet s'mbarojnë këtu, por vazhdojnë me teoritë për kombin kosovar e gjepura tjera, se gjoja perandoria osmane s'na paska qenë pushtuese, por administruese. Rihapja e këtyre temave, edhe njëherë e ka parashtruar nevojën e qartësisë të raporteve tona me vetveten. Pikërisht për këtë, shkrimtari ynë më i afirmuar dhe një nga mendjet më të mbrehta, Ismail Kadare ka shkruar një libër testamentar, "Mosmarrëveshja-Shqipëria përballë vetvetes", ku me një analizë të shkëlqyeshme e ve shqiptarin para përgjegjësisë kombëtare, që të qartësojë veten dhe ndërgjegjen e tij në raport me të shkuarën dhe kështu të hap shtigje për të ardhmen.

(vijon)



### Shkruan: Mr. Sarë Gjergji

Sarë Gjergji u lind më 15.12.1965 në Stubëll të Epërme të Vitisë. Kreu studimet për Letërsi dhe gjuhë shqipe në Universitetin e Prishtinës, ku dhe vijon edhe studimet postdiplomike. Pos tjerash, ka botuar edhe këta libra me poezi: "Golgotë", Drita, Ferizaj, 1994; "Kontrast ngjyrash", Prometheus, Graz, 1996; "Terapia e vdekjes – requiem për Kosovën", Martin Segoni & Ura, Gjiilan, 2000; "Peizazh toke", Eurorilindja, Tiranë, 2004, etj. Në Bukuresht, në përkujdesje dhe përkthim të Baki Ymerit ka botuar (në rumanisht) librin "Zjarr i pashuar". Ka qenë themelues dhe kryeredaktor i parë i revistës "Lajmëtari", në Graz si dhe kryeredaktor i revistës "Identiteti", që botohej pas lufte në Prishtinë. Është dhe fitues i disa çmimeve letrare për poezi dhe organizator i manifestimit letrar, kulturor e shkencor "Takimet e Dom Mikelit" si dhe botues i buletinit të manifestimit me të njëjtin emër.

## Kosova, pesë vjet pas pavarësisë

Për çfarë Kosove mund të flasim, katërbëdhjetë vjet pas përfundimit të luftës e pesë vjet pas shpalljes së saj shtet i pavarur?

Fillimisht do thënë se qytetarët e Kosovës, përfshirë këtu edhe autorin e këtij shkrimi, janë krenarë me shtetin e tyre. Ndonëse papunësia arrin në shkallë prej rreth 50%, që për pasojë ka dhe varfërinë jo të vogël, kosovarët janë mbase populli më optimistë në rruzullin tokësor. Ky optimizëm, ndërkaq, nuk nxitet as motivohet nga puna e angazhimi i qeverisë dhe i partive politike, i aparatit shtetëror të Republikës së Kosovës a i mekanizmave të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë. Është një optimizëm që rrjedh nga shpirti i vuajtur i qytetarit të saj ndër shekuj: shpresa vdes e fundit, ajo është thesar i të varfrit, thotë një fjalë e urtë e popullit...

Qytetarët e Kosovës, në të shumtën e rasteve, qeverinë e vendit e cilësojnë të jetë (qeveri) e korruptuar; korrupsionin burim të të gjitha pengesave e barrierave për një zhvillim normal dhe ecje përpara (edhe drejt integritimit në BE). Jo vetëm ekspertë të ekonomisë, por edhe qytetarët e rëndomtë (të Kosovës), mund të vlerësojnë pa ndonjë vështirësi të madhe për ngecjet dhe të arriturat në ekonomi dhe në sfera të tjera të shoqërisë kosovare. Dhe, si konstatim i përbashkët rezultojnë: niveli tepër i ultë dhe i pamjaftueshëm i zhvillimit ekonomik të vendit, një ekonomi e brishtë, sektori privat, pa mbështetjen e duhur institucionale, ani pse cilësohet bartës kryesor i zhvillimit ekonomik, klimë, ambient jo i përshtatshëm afarist për investitorë, sidomos të jashtëm (për shkaqe më shumë të natyrës korruptuese se sa ligjore), deficitit tregtar (të hyrat më të mëdha buxhetore të Kosovës mbështeten tek doganat: importi është shumëfish më i madh se sa eksporti), investimet fare të vogla në kulturë (përfshirë investimet për ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore, shpirtërore të pakicave kombëtare, me theks të veçantë të asaj serbe), gjendja jo e kënaqshme në arsim (shkollat janë të tejngarkuara me nxënës) e shëndetësi (qytetarët janë ende pa sigurime shëndetësore) etj.

Përkundër kësaj, Kosova, megjithatë, ka arritur të anëtarësohet në Bankën Botërore, në BERZH e në Fondin Monetarë Ndërkombëtarë, mekanizma financiarë këta që do i japin një shtysë zhvillimit të gjithmbarshëm të vendit në të ardhmen. Kosova ka bërë mjaft shumë në integrimin e pakicave kombëtare në rrjedhat e gjithmbarshme shoqërore. Procesi i decentralizimit ka dhënë frytet e saj. Por, a është i mjaftueshëm ky anëtarësim në raport me pritjet që kanë qytetarët e Kosovës për një jetë më të denjë, për një standard e cilësi tjetër të jetesës së tyre, për liberalizim të vizave e për integrim në familjen e madhe të quajtur BE? Sigurisht që jo. Madje nuk janë këto as pritjet e bashkësisë ndërkombëtare. Qeveria e Kosovës, do duhej të bënte, gjithsesi, më shumë për funksionalizimin e sistemit të drejtësisë, për një reformim thelbësor të saj, për forcimin e ligjit dhe të rendit, të bënte më tepër në luftimin e krimit (të organizuar), të hartonte strategji e programe të qarta ekonomike etj.etj.. Kjo do ndihmonte edhe rritjen ekonomike, investimet e huaja, zvogëlimin e numrit të të papunëve (Kosova ka një popullsi shumë të re, aktive për punë dhe një pozitë gjeografike të përshtatshme), së këndejmi dhe në ngritjen e nivelit të jetesës.

Veriu i Kosovës dhe radikalizmi i mundshëm islamik mbeten sfidë jo e lehtë për Kosovën dhe institucionet e saja. Është e para që nxit të dytën, por jo vetëm ajo. Asnjëra me fajin e institucioneve të Kosovës, sado paradoksale të

duket kjo. Problemi i veriut ndodh në kuadër të politikave ndërkombëtare, ndërsa nxitja për një islamizëm "më të ashpër", ndodh edhe për shkak të investimeve që bëjnë organizata të ndryshme (sidomos nga bota arabe). Përderisa Mitrovica rezultojnë lehtë e "humbur", si shenjë kompromisi me Serbinë, në të cilën thirret bashkësia ndërkombëtare, ndërkohë që këtu nuk kemi kurrfarë kompromisi, meqë Kosova humb territorin e saj e nuk fiton asgjë, radikalizmi i mundshëm i islamizmit në Kosovë ose orientimi i kosovarëve drejt Lindjes, mund të evitohet. Por, që kjo të ndodh, duhet dhe një qëndrim i qartë dhe dashamirës i bashkësisë ndërkombëtare karshi Kosovës, të cilën duhet ta konsiderojnë evropiane jo vetëm në rrafshin gjeografik, por edhe në aspektin kulturor. Shqiptarët janë historikisht një popull i krishterë, që do thotë me një kulturë e mentalitet perëndimor. S'do harruar faktin se është Shën Jeronimi Ilir që i dha Vulgatën (Biblën) civilizimit perëndimor, është Shën Niketë Dardani që i dha kishës himnin e saj, "Te Deum-in", është Skënderbeu, Atleti i Krishtit që mbrojti civilizimin perëndimor nga hordhitë anadollake, është Nënë Tereza, shembulli më emblematic që e dëshmoi si askush tjetër kulturën, mentalitetin, humanizmin e civilizimin perëndimor.

Shqiptarët jetojnë me këtë vetëdije, të cilën Evropa duhet ta ketë parasysh e t'mos e injorojë. Evropa mund dhe duhet ta zgjidh problemin e Kosovës dhe ta pranojë në gjirin e vet. Atëherë do kemi një Kosovë evropiane në të gjitha nivelet. Atëherë do kemi dhe një qeveri ndryshe...





### Intervistë me aktivisten dhe udhëheqësen e shoqatës “12 qershori”, Rolanda Limani

E lindur me 13 dhjetor 1973 në Gjakovë, me 1992 ka ardhur në Austri. Nga viti 1997 deri me 2010 ka qenë e angazhuar në Ministrinë e Puneve të Brendshme të Austrisë si përkthyes në qenderën e azil-kërkuesve në Traiskirchen. Përveç punës si përkthyes është marrë edhe me shumë aktivitete dhe projekte të ndryshme shtetërore austriake.

#### Znj. Limani, si ishte gjendja në skenën e shoqatave shqiptare në Austri në kohën kur ju erdhët në këtë shtet?

Të ju them të drejtën, në këtë periudhë unë nuk kisha shumë kohë të bëjë një vlerësim të gjendjes së shoqatave në Austri. Por ajo çka tek unë ka lënë gjurmë të pashlyeshme ka qenë represioni dhe tortura serbe që ushtrohej në Kosovë mbi popullatën shqiptare në fillim të viteve 1990-ta. Në atë situatë shqiptarët proekupoheshin me organizimin e ndihmave dhe formave tjera për rezistencë kundër pushtuesit. Për aktivitete kulturore pakkujt i shkonte mendja. Në këtë drejtim unë ju jap edhe të drejtë sepse nuk ishte momenti për këngë dhe valle kur atdheut i kanosej rreziku nga pushtusi serb. Edhe unë aktualisht tim fillimisht e kanalizova në organizimin e ndihmave dhe formave tjera që ishin të domosdoshme për këtë kohë. Zatën çdo shqiptar ishte në shërbim të atdheut për të kontribuar me aq sa kishte mundësi.

#### Kur dhe në çfarë forme u aktivizuat për herë të parë në aktivitetet e mërgatës sonë në Austri?

Unë edhe në Gjakovë, prej nga vij, kam qenë e kyqur në shumë aktivitete. Sa i përket aktiviteteve kulturore ato i kam pasur në shpirt që në moshën e re. Falë shoqërive kulturo-artistike “Ereniku” dhe “Asim Vokshi” në Gjakovë unë kam pasur rastin që të tregoj talentin tim si valltare. Dhe që nga ajo kohë e deri më sot nuk i jam ndarë këtij talenti dhe shpërndarjes së tij nëpër gjenerata të reja. Kontributi i gruas shqiptare në Austri ka qenë i padukshëm dhe i paprekshëm nga ai mentaliteti i vjetër se gratë nuk janë të zonjat për punë të mëdha, edhe pse historia flet të kundërtën. Mua si një vajzë e re por e brymosur me konceptin se atdheu ndihmohet edhe nga mërgimi, më lindi ideja që të kontribuoj në ndryshimin e kësaj situatë nëpër të cilën po kalonte mërgata shqiptare në Austri si vend të krijon mundësinë për të zhvilluar aktivitetet. Vështirësitë e para i hasa tek mentaliteti i vjetër mashkullor, sepse çdo shoqatë që ekzistonte këtu në radhat e veta nuk kishin pothuaj asnjë vajzë aktiviste që aktivitetin dhe dijen e vetë të fituar në atdhe donte ta shkrinte tek fëmijët e mërgimtarëve. Iniciativën e parë e mora në vitin 2002, kuptohet kur edhe u krijuan kushtet në atdhe dhe në diasporë për të zhvilluar aktivitete kulturore. Fillimisht aktivizova disa fëmijë të atyre prindërve që vërtet ndjenja për kulturën dhe traditën e atdheut i përcillte edhe në mërgim dhe këtë ndjenjë donin ta përcillnin edhe tek fëmijët e tyre të cilëve po i kanosej asimilimi gjuhësor dhe kulturor. Aty ku unë jetoja, në qytetin Baden, formova një grup që në fillim e pagëzuam “Grupi i valleve shqiptare”. Kjo ide u mirëprit nga shumë bashkëatdhetarë tanë sepse ishte një risi për të gjithë mërgimtarët në Baden dhe rrethinë.

#### Cili është historiku i shoqatës kulturore “12 qershori”?

Shoqata kulturore “12 Qershori” ka filluar për herë të parë aktivitetin e vet siç e përmenda më sipër në vitin 2002, ndërsa paraqitja e valleve të para u bë më 28 nëntor 2003, kohë kjo kur shoqata mori hovin dhe jehonën në mbarë Austrinë dhe jashtë saj. Pas shumë paraqitjeve dhe sukseseve në Baden, Vjenë, dhe qytete të tjera brenda Austrisë, aktiviteti ynë shpërtheu edhe përtej kufive të këtij shteti. Dalja jashtë Austrisë me programin tonë ishte Berlina në Gjermani ku morëm pjesë në Festivalin “Ditët e Kulturës shqiptare në diasporë-Berlini 2005”. Grupi ynë i valleve zuri vendin e dytë për paraqitje profesionale dhe për motive autoktone të valleve. Në vitin 2006 u shpërblyem si grupi më simpatik për kostumet origjinale dhe interpretimin e valleve. Pas këtyre rezultateve dhe pritjes së mirë nga publiku shoqata u zyrtarizua pranë autoriteteve austriake dhe e pagëzuam me emrin “12 qershori” që përkon me hyrjen e trupave të NATO në Kosovë në vitin

1999. Datë kjo që ka lënë gjurmë tek çdo shqiptar anë e kënd botës. Që nga viti 2006 kjo shoqatë vazhdon të jetë bartëse kryesore e aktiviteteve kulturore të shqiptarëve në Austri, me ç’rast falenderoj aktivistët dhe dashamirësit e shoqatës sonë të cilët japin gjithmonë kontributin e tyre për qhoqatën “12 Qershori”.

#### Sa keni gjetur përkrahje në komunitet për projektet tuaja dhe si arrini që të mblidhni rreth vetes një numër kaq të madh të anëtarëve të grupit?

Përkrahja nga komuniteti është vërtet për t’u dëshiruar. Deri tani kemi pasur përkrahje të lartë nga afaristët shqiptarë, prindërit e fëmijëve anëtarë të shoqatës, individ privatë, studentë shqiptarë në Austri, si dhe nga dy ambasadat shqiptare në Vjenë, ajo e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës. Kjo përkrahje jam e bindur se vjen si rezultat i aktiviteteve tona të pandalshme të cilat kanë ndihmuar që t’i mbajmë shqiptarët sa më pranë vetes, dhe në anën tjetër edhe vet interesimi që kanë treguar shqiptarët për këto aktivitete. Unë kam vlerësuar gadishmërinë e prindërve, të cilët janë të interesuar që fëmijët e tyre t’i angazhojnë në aktivitete që i lidhin me kulturën dhe traditën e atdheut dhe sjellja e tyre pa përtesë në ushtrime në shoqatë është vendi më i mirë që i lidhë fëmijët e tyre me atdheun. Aty këndohet, flitet dhe vallëzohet shqip. Ky edhe është qëllimi ynë-që fëmijëve të ju krijojmë një ambient shqiptar në një mes ku dominojnë kultura të ndryshme. Me punën intensive dhe korrekte u kam dëshmuar bashkëatdhetarëve të mi që mbi bazën e respektit reciprok mund të korrrësh frytet e kësaj pune.

#### Cilët janë donatorët tuaj kryesor?

Aktivitet tona kryesisht janë financuar nga afaristët shqiptarë të

Vjenës. Ata kanë financuar çdo aktivitet tonë artistik dhe janë mbështetës të mëdhenj të punës sonë. Përkrahje kemi pasur edhe nga Ambasada e Kosovës dhe Ambasada e Shqipërisë. Ndërkohë që shumë individë tjerë na kanë përkrahur në forma të ndryshme, duke kontribuar me punë vullnetare. Me këtë rast dëshiroj t'i falënderoj të gjithë ata të cilët ndihmojnë aktivitetet tona. Besoj që këtë ndihmë po ua kthejmë me shumë krenari duke i shpërblyer ata me program cilësor në festat tona kombëtare. Përfitoj nga rasti t'i falënderoj publikisht, në emrin tim dhe të shoqatës, dhe të ju uroj fat në këtë vit me dëshirë që të kenë paqe dhe lumturi në familjet e tyre, si dhe sukses në veprimtaritë e tyre biznesore. Kontributi i tyre financiar dhe kontributi ynë artistik ka bërë që të kemi një bashkëpunim reciprok mes njëri-tjetrit.

### **Cili është bashkëpunimi juaj me organizatat dhe autoritetet shtetërore austriake?**

Autoritet shtetërore austriake e kanë mirëpritur këtë nismë dhe kemi lidhur bashkëpunime të ngushta me disa shoqata austriake. Dita ditës fitojmë besim më të madh dhe vazhdimisht jemi pjesëmarrës me këngë dhe valle shqipe në organizimet e tyre. Vitin e kaluar kemi qenë pjesëmarrës në shtatë aktivitete të tilla në qytete të ndryshme të Austrisë. Bashkëpunimi do të rritet dhe së shpejti edhe ato do të marrin pjesë në organizimet tona.

### **Ju udhëhiqni edhe një zyrë për asistencë të huajve në Vjenë. A mund të na tregoni më shumë lidhur me shërbimet që ofroni në këtë kuadër?**

Qëllimi i nismës sime në këtë fushë ka qenë dhe mbetet dëshira për të ndihmuar bashkatdhetarët. Unë përpiqem që t'ua lehtësoj rrugën e tyre të integritit dhe lehtësimin e problemeve me të cilat ballafaqohen me institucionet shtetërore Austriake (si, sqarimi në detaje i dokumentacionit dhe të drejtat që ata gëzojnë si të huaj në shtetin austriak). Besoj që zyra të cilën e drejtoj unë me llojllojshmërinë e veprimtarive që ushtrojmë në këtu do jetë ndihmesë e madhe për bashkatdhetarët tanë.

### **Cili është mendimi juaj për jetën kulturore të mërgatës shqiptare në Austri?**

Nëse bëjë një krahasim me kohën kur unë kam ardhur në Austri sigurisht se ka përmirësime dhe dua të përmend këtu faktin, se pas iniciativës time në vitin 2002 për krijimin e "Grupi i valleve shqiptare" dhe themelimin e shoqatës kulturore "12 qershor" në vitin 2006 puna ime shërbeu si model edhe për shqiptarët e tjerë në mbarë Austrinë. Pra, për të themeluar shoqata të reja me po të njëjtin profil. Shpërngulja ime nga Badeni në Vjenë vjen si rezultat i interesimit të madh të fëmijëve dhe rinisë shqiptare në Vjenë që edhe këtu të ketë një shoqatë të tillë me njerëz kompetent në këtë fushë. Mbi të gjitha Vjena është kryeqyteti i Austrisë dhe ofron shumë më shumë hapësirë për aktivitete kulturore, por edhe nga fakti se në Vjenë janë edhe dy ambasadat shqiptare, ajo e Shqipërisë dhe e Kosovës.

### **Cilat janë planet tuaja për të ardhmen si shoqatë dhe si aktiviste?**

Planet tona dihen. Ato janë si një lloj kushtetute për ne sepse obligimi ynë i parë është të shënojmë të gjitha festat tona kombëtare, të ju ofrojmë kënaqësi të gjithë fëmijëve të anëtarësuar në shoqatën tonë dhe sa më shumë t'i lidhim me atdheun dhe vendlindjet e tyre. Në shoqatën tonë, për ato pak orë sa janë në ushtrime, fëmijët komunikojnë shqip, degjojnë muzikë shqipe dhe natyrisht kurorëzim i gjithë kësaj është paraqitja në program dhe pjesëmarrja në ndonjë program festiv si dhe bashkëpunimi me shoqatat simotra në Austri dhe jashtë saj.

### **Mesazhi juaja për lexuesit e revistës "Dielli Demokristian"?**

Së pari uroj të gjithë lexuesit e revistës "Dielli Demokristian" një vit plot shëndet në familje e tyre, suksese në punë dhe një vit të mbarë në të gjitha veprimtaritë e tyre. Dëshiroj t'u përcjellë mesazhin se misioni i secilit prej nesh nuk mbaron këtu. Për ju prindër: -Le të bëjmë më të mirën në profesionet tona, të integrohemi sa më mirë në shtetin mikpritës austriak në

të gjitha fushat e jetës, si në punësim, shkollim, informimi, shkëmbimin e njohurive pa harruar vlerat dhe identitetin tonë, në mënyrë që të mos ndodhë tek fëmijët tonë asimilimi. Ndërsa për gjeneratën e re dhe fëmijët: - Informohuni dhe lexoni sa më shumë, arsimohuni, sepse ju jeni e ardhmja e kombit dhe çdo dije është një çelës për të hapur derën e suksesit të secilit prej jush.

*Intervistoi: Anita Marku*



### Intervistë me artistin Fadil Tafili, Grac/Vjenë

Është lindur në Rugovë të Pejës, në fshatin Drelaj. Ka përfunduar shkollën e lartë teknike të makinerisë dhe studimet e larta ndërsa ka punuar në fabrikën e autopjesëve në Pejë. Që nga rinia ishte i brymosur me ndjenja kombëtare dhe vazhdoi aktivitetet e tij edhe pas ardhjes në Austri, në Grac dhe Vjenë.

#### Cilat ishin arsyet kryesore që ju shtynë të migroni nga Kosova në Austri?

Fundi i viteve 1980-ta në Kosovë mbahet mend si vit i izolimeve të veprimtarëve dhe intelektualëve shqiptarë nga ana e regjimit serb. Unë u largova në mënyrë që t'i evitoj maltretimet që po bëheshin gjithandej.

#### Sa ishte i vështirë fillimi i një kapitull të ri jetësor larg vendlindjes?

Fillimi nuk ishte i lehtë. Kjo për më shumë se nuk e dija se ku po shkoj dhe çka më pret.

#### Cilat ishin sfidat e para me të cilat u ballafaquat pas ardhjes suaj në qytetin e Grac-it?

Kisha fat për faktin se gjeta një zgjidhje të shpejtë për çështjen e banimit. Po ashtu dhe me punësim. Per sa i përket gjuhës gjermane arrita që shumë shpejt të mësoj gjërat elementare për komunikim.

#### Çfarë ju motivoi që të mbështesni aktivitete në të cilat merrnin pjesë shqiptarët që jetonin në Grac?

Në Kosovë kisha lënë një gjendje të vështirë. Në qytetin e Gracit u aktivizova menjëherë në një shoqatë, ndërsa me vet-inicativë bëmë të mundur themelimin e shoqatës "Karl Gega" (inxhinier i njohur shqiptaro-austriak) e cila ndihmoi shumë në mbledhjen e ndihmave të ndryshme të dërguara edhe përmes organizatës "Caritas", duke përmirësuar kështu edhe imazhin e shqiptarëve në këtë shtet.

#### Cili është profesioni juaj kryesor e cilët janë hobet tuaja?

Une jam inxhinier i makinerisë, ndërsa hobi im është arti modern metalik.

#### Kur filluat të merreni me pikturim në material llamarine, dhe a mund të na sqaroni teknikën e punës suaj?

Që si i ri e kam dashur artin. Artin metalik në bakër kam filluar ta përdor në vitet 1994-95 duke dizajnuar portrete të heronjëve kombëtar, që ishin disa nga dekorimet e shoqatës ku isha aktiv edhe në Grac. Në këtë drejtim kam pasur një ndërpreje prej 6 viteve, në kohën kur, në luftën në Kosovë m'i vranë prindërit dhe 5 anëtarë të familjes në Katundin e Ri, në Pejë. Nga viti 2006 merrem me artin e ri modern metalik.

#### Si është pritur arti juaj nga publiku austriak dhe a keni pasur ndonjë ekspozitë deri më tani?

Fillimisht ky art për mua ishte hobi. Por, ka dy vite që jam duke u marrë profesionalisht me të. Deri më tani në Grac kam hapur dy ekspozita. Punimet e mia gjenden dhe në disa galeri dhe lokale në Vjenë. Tash jam në fazën e parë të realizimit të projektit madhor "Piktura e Paqes" e cila pres se do të hyjë në librin e rekorderve të Guinnessit. Po ashtu jam duke bërë gati edhe një libër për artin modern metalik.

#### Ju jeni edhe anëtar i shoqatës kulturore "Aleksandër Moisiu" në Vjenë. Në një orë letrare të mbajtur në dhjetor të vitit të kaluar ju dhuroat një punim artistik për Ambasadën e Shqipërisë në Vjenë? Cili ishte motivi juaj për të bërë këtë akt simbolik?

Çdo shqiptar e ka për detyrë që aty ku jeton të kontribojë me atë që ka mundësi. Shoqata "Aleksandër Moisiu" është një subjekt i organizuar mirë, me anëtarë që e duan dhe e promovojnë kulturën dhe artin shqiptar. Për mua është kënaqësi të jem pjesë e saj.

#### Si do të mund të ju kontaktojnë lexuesit tanë dhe të interesuarit tjerë?

Të gjithë të interesuarit për artin tim mund të më kontaktojnë përmes e-mail-it [fadiltafili@hotmail.com](mailto:fadiltafili@hotmail.com) dhe në numrin e telefonit 0043/(0)676 951 34 09. Po ashtu bëj me dije publikun e gjërë se mund t'i realizoj në pllakë metalike portretet e përzgjedhura, me motive kombëtare, familjare apo individuale.

#### Sa mendoni se është e organizuar mirë mërgata shqiptare në Austri dhe çfarë mund të bëjnë më mirë ata?

Mendoj se janë duke u zhvilluar disa aktivitete të mira. Por, duke u bazuar në numrin e bashkëatdhtarëve tanë në Austri duhet dhe mund të bëhet më shumë, sidomos në aktivizimin dhe mbështetjen e gjeneratave të reja.

*Intervistoi: Lush Neziri*

## Histori

**Shkruan: Brahim Avdyli, Zvicër**

Autori u lind me 5 shtator 1960 në fshatin Morinë të Gjakovës. Fakultetin Filologjik e kreu në Universitetin e Prishtinës-drejtimi letërsi dhe gjuhë shqipe. Pastaj përfundoi kursin pasuniversitar në akademinë diplomatike shqiptare në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë. Më vonë përmbyll edhe studimet postdiplomike në Universitetin e Strugës, gjegjësisht në fakultetin e shkencave politike, me ç'rast mbrojti temën e magistraturës në lëminë e mërgatës shqiptare të Zvicrës. Ka botuar shumë shkrime, artikuj dhe analiza. Gjatë viteve 1990-1995 ka udhëhequr revistën "Qëndresa" në Zvicër. Poezia e tij është përkthyer në italisht, gjermanisht, rumanisht, anglisht. etj. Ai është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, i Autorëve të Zvicrës (AdS), i Shoqatës së Krijuesve Shqiptarë të Zvicrës dhe i Lidhjes Ndërkombëtare të Poetëve, Shkrimtarëve dhe Artistëve Shqiptarë.

**Prejardhja e kombit shqiptar dhe armiqtë shekullorë**

*Shqiptarët janë një popull shumë i vjetër dhe i veçantë në Evropë dhe në Ballkan, me një autoktoni të përhershme në këto troje*

Edhe kroatët e shekullit të VI-VII, qenë vendosur si kalorës mercenarë të Perandorisë Bizantine në kohën e Jusinianit I, me qëllim që të mbronin kufirin nga dyndjet e Gadishullit Apenin. Ata u shkrinë shpejtë me dalmatët, istrianët, etj. dhe kanë rrënjën ilire, gëzojnë trashëgiminë e tyre, veçanërisht të dalmacisë, por emri i tyre ka rrjedhje prej herv-ati=kalorës nga Hervi, që është një qytet në Afganistan. Ky popull e ka marrë këtë emër më vonë, për tu distancuar prej serbëve katolikë ortodoksë, sepse ishin katolikë romakë dhe në bazë të tij kemi kombin hervat dhe shtetin hervat-kroat (Hervatska)- Kroacia<sup>3</sup>.

Emri i vjetër i madeqonisë "makedonia" ka prejardhje ilire, shqipe dhe është me liqenj të Prespës, Ohrit dhe Dorianit. Emri make-d-oni-a do të thotë onë, anë=dheu, pra territor me makëra; sepse mak-ë, ra janë bimë uji që rriten pranë bregut të liqenit mbi gurë si fije mëndafshi me ngjyrë të gjelbërt, alge)<sup>4</sup> ka shpjegim në gjuhën shqipe. "Kombi maqedon" është tërësisht një komb artificial i krijuar nga sllavo-bullgarët dhe shqiptarët ortodoksë, me vllhtë dhe fise tjera turke (komanët, peçenekët, etj.) të ortodoksuar, kurse maqedonishtja është formuar nga elementet e shqipes, vllahishtes dhe turqistes<sup>5</sup>, që flasin bullgarisht, me fjalë të zgjatura, me "ta-ta"-të e dyfishuara.

Antroponimet, toponimet dhe mikrotopnimet „sllave“ nga territoret tona nuk janë sllave, por janë ortodokse dhe bogumile (patarene) në faltoret e të cilave përdorej gjuha kishtare e formuar nga Qirili dhe Metodi. Në Ballkan kanë ardhur në mes të shekujve VI e XIII fiset avare, mongole, peçenegët, dhe sllavët dhe janë asimiluar e jo zhdukur, siç thotë pa arsyetim shkencetari i njohur amerikan, Ferdinand Schewil<sup>6</sup>, me pakicën e skllavëve, të jevgjitëve, të ebrejve, të vllhëve në këto anë. Ata janë shkrirë me popullsinë vendase ilire, duke kryer simbiozën etnike, me ç'rast mbizotërojnë veçoritë antropologjike të pellazgo- iliro-shqiptarëve. Shqiptarët, dallohen nga popujt sllav. Të thënë tekstualisht, ata kanë qenë mbizotërues dhe janë edhe sot. Serbishtja, si gjuhë kombëtare dhe letrare e serbëve është krijuar nga Vuk

Kara-gjiqi, në shekullin XIX, ndërkaq përmendet ajo gjuhë nga gjysma e dytë e shekullit XII. Shqipja ka qenë gjuhë familjare dhe popullore deri në shekullin e XIX, e në disa familje serbe, deri në ditët tona. Gjuha kishtare u formua nga Qirili dhe vëllai i tij Metodi, në Moravi, në vitin 864, në një mision të veçantë. Këta dy murgj evrej (që thirren sot jahudi, izraelitë) nga Selaniku, për të përkthyer pjesë të Biblës dhe të liturgjisë, përdorën një gjuhë që mund të flitej në rajonet skllave të Maqedonisë, të cilën nuk e kuptonin "moravët e Ballkanit". Pra, rezultatet e tyre të sllavishtes maqedone ishin më tepër se zhgënjyese, sepse nuk shkruhej aspak në atë kohë<sup>7</sup>, e jo në shekullin e XI, siç e thotë këtë gjë Fatbardha Demi, por në shekullin e IX. Ata e quajtën këtë gjuhë „Gjuhë ilire“ (Illyrika Lingua), sepse po formohej për të krijuar kulturën dhe gjuhën e veçantë sllave-ballkanase nëpër territoret ku flitej gjuha ilire. Kësisojit, me "të drejtën e fituesit, të ngadhnjimtarit" justifikohet çdo pretendim territorial, çdo pretendim i trashëgimisë, i origjinës, i pasurisë, asaj kulturore, arkeolo-gjike, historike etj, e deri te ajo gjuhësore<sup>8</sup>.

Më vonë nga pansllavizmi i lëshuar si „lëvizje e të gjithë sllavëve“, nga pansllavizmi, në të cilën u kyqën popujt e ballkanit që mbanin veten të këtyllë, është quajtur „gjuha e vjetër sllave“. Serbët, ngaqë kishin sjellur nga Azia Qendrore një sekt të krishterizmit, të cilën papati e quante „skizmë“, atëherë ithtarët e kishës ortodokse ku përdorej „gjuha ilire“ quheshin serbë, pa marrë parasysh se në cilën pjesë të Ballkanit jetonin ata dhe vepronin, pa marrë parasysh etnikisht nëse ishin shqiptarë, turq apo vllh<sup>9</sup>. Tri fetë janë krijuar nga ne dhe janë hakmarrë deri në fund mbi shqiptarët.<sup>10</sup> Feja e shqiptarit është kurdoherë Shqipëria, thotë i ndritëshmi, Vaso Pashë Shkodrani. Kjo është prejardhja e kombit shqiptar, origjina dhe territoret që ka zënë dikur. Njëkohësisht, flitet për armiqtë e tij shekullorë.

**(fund)**

<sup>3</sup> Po aty, në fusnotë, faqe 26

<sup>4</sup> Po aty, në fusnotë, faqe 28

<sup>5</sup> Po aty, në fusnotë, faqe 27

<sup>6</sup> Shiko veprën e Ferdinand Schewillit, "Ballkani...", faqe 71

<sup>7</sup> John Julius Norwich, "Bizanti, shkëlqimi dhe rënia e një perandorie 330-1453", Eugen, Tiranë 2005, faqe 40-41.

<sup>8</sup> shiko shkrimin e Fatbardha Demit, "Ideologjia politike e historiografisë Europiane", te [www.pashtriku.org](http://www.pashtriku.org).

<sup>9</sup> Prof. Dr. Skender Rizaj, vepra e cituar, në fusnotë, faqe 27

<sup>10</sup> shikoni në mënyrë të pashkëputur shkrimin tim, për këtë temë.





**Shkruan: Gjon Keka, Grac (Austri), politolog, Ph.D. kandidat në shkencë politike në Emuni University dhe ADA**

## Pellazgo-ilirët dhe pasardhësit shqiptar

(pjesa e parë)

Çështja e prejardhjes së shqiptarëve ka qenë një nga temat më të diskutueshme për historianët, gjuhëtarët, gjeografët, shkencëtarët e ndryshëm, njerëzit e urët, studiuesit etj, dhe mund të thuhet se që të gjithë kanë treguar në mënyrë tepër bindëse dhe jo hipotetike për një vazhdimësi të gjuhës shqipe që nga koha e pellazgo-ilireve dhe përkatësisë së kombit shqiptar si i vetmi komb që identifikohet natyrshëm me pellasgët e që në fakt janë vetë shqiptarët. Kjo për faktin se ata janë mbështetur edhe në karakterin, gjenin, imazhin, racën, gjuhën, etj.

Interesimi i shtuar për të njohur më thellë gjenezën dhe rrënjët e kombit lashtë shqiptar ishte i madh sidomos tek historianët gjermanë, italianë, francezë e suedezë. Të gjitha ata bënin studime të thella të etnografisë, antropologjisë dhe atë të çështjes së gjuhësisë për të mbërritur kështu tek konkluzioni i tyre studimore se pellazgo-ilirët janë shqiptarët e sotëm. Kjo vazhdimësi dhe ruajtje e kësaj race ka ardhur si rezultat se ky komb edhe përkundër asaj që ishte i pushtuar nga pushtuesit barbar të ndryshëm në esencën e ka ruajtur gjenin, gjuhën dhe karakterin prej shqiptari dhe si të lashtët e gadishullit Ilirik.

Në gjykimin e të gjithë këtyre studiuesve, historianëve dhe kritikëve të paanshëm është fakti se ata kanë identifikuar qartë pellazgo-ilirët me emrin e shqiptarëve si komb. Kjo tregon se ata kanë arritur kështu të nxjerrin nga thellësia e kohëve famën e madhe të kombit të lashtë shqiptar, si një komb që ka prejardhje të drejtpërdrejtë pellazgo-biblike. Me studimet e tyre të thella dhe tezat e shtruar rreth origjinës pellazgo-shqiptare ata kanë arritur të gjejnë vetëm vendin e thesarit të gadishullit Ilirik, ndërsa studimet e mëtutjeshme, në vijim dhe gërmimet hulumtuese, nënkuptojnë më saktësisht rrugëtimin e tyre edhe në kohët tona drejt gjetjes edhe të thesarit të plotë të këtij gadishulli dhe prejardhjes së thellë të origjinës së kombit shqiptar dhe gjuhës së lashtë të tij pellazgo-ilirike.

Edhe pse më herët është thënë se origjina e pellazgëve është një mister në historinë e saj me nxjerrjen e këtyre argumenteve dhe studimeve serioze të autorëve perëndimor dhe historianëve me nam ndërkombëtar. Edhe pse jemi në shekullin XXI nuk është ngritur ndonjë tezë e re apo nuk është gjetur ndonjë dokument apo gjetje tjetër që rrëzon apo redukton këto të dhëna dhe dokumenteve etnologjike, linguistike, arkeologjike

se shqiptarët janë pasardhës të drejtpërdrejtë të pellazgo-ilirëve.

Tani me studime e tilla të këtyre autorëve serioz rreth origjinës pellazgo-shqiptare më nuk ka mbetur asnjë pasiguri për të trajtuar këtë çështje edhe në ditët tona me një seriozitet dhe energji edhe më të shtuar në gjetjen dhe prurjen e plotë të bërthamës vertikale dhe horizontale të pellazgo-shqiptarëve. Një studim edhe më i thelluar dhe permanent i studiuesve të rinj, sidomos tani në këtë shekull, do të sillte një gjetje të plotë të tërë kësaj origjine që ka qëndruar së bashku me thellësitë e kohëve misterioze dhe me plotë dyshime e pasiguri. Prandaj duke u bazuar në studimet e autorëve që kanë trajtuar këtë çështje dhe risitë që do të mund të shfaqen, pasiguria dhe dyshimet do të binin përball diellit që do të lindte dhe do ta ndriçonte në tërësi tërë historinë e origjinës pellazgo-shqiptare.

Nisur nga kjo mund të nënvizoj se historia është një besëlidhje në mes të burimit të argumenteve (dokumente) të kohërave dhe historianit, ndërsa shpirti i kombeve është garanci e kësaj besëlidhje. Prandaj askush nuk mund të ndryshoj apo të ndërhyj në këtë besëlidhje të fuqishme të kombeve me vetveten dhe historinë e tyre burimore. Njëri nga studiuesit më serioz rreth lashtësisë së shqiptarëve si komb dhe gjuhës së tyre si një nga më të lashtët, dhe që rrjedh nga pellazgo-iliristja, është ipeshkvi Giuseppe Crispi, profesor dhe drejtues në Universitetin e Palermos. Ai sjell dëshmi dhe gjurmë e reja. S gjetje të tij gjatë hulumtimeve mbi origjinën pellazge dhe lidhshmëritë natyrore të saj me gjuhën shqipe, ai madje në "Memorien e thelle të tij mbi gjuhën shqipe" thekson se, përveç asaj që gjuha shqipe është gjuhë pellazgo-ilire, ai e sheh këtë gjuhë si "dominues "në gadishullin Ilirik dhe e cilëson si "gjuhë të Perëndisë me një marrëdhënie të thellë historike" si dhe si "nëna e gjuhëve" (Opuscoli di letteratura e di archeologia di monsig. Giuseppe Crispi, 1836) në këtë gadishull të lashtë.

Duhet nënvizuar se gjetjet e reja të autorëve të shumtë gjatë hulumtimeve të tyre dhe studimeve serioze të dokumenteve kanë sqaruar se qytetërimi i vjetër në gadishullin ilirik nuk ishte askush tjetër por pellazgo-ilirët të cilët përbëjnë zanafillën dhe simbolikën e gjuhës së tërë kohës dhe të kuptuarit e tërësishtëm të vetë fenomeneve dhe misterit që ka qëndruar gjer në ditët tona rreth origjinës së pellazgo-ilirëve se ata janë rrënjë e qytetërimin të përbashkët evropian dhe shqiptarët janë pasardhës të natyrshëm të tyre.

(vijon)



**Shkruan: Hazir Mehmeti, mësues dhe gazetar në Vjenë**

## Vjena, vendqëndrimi e veprimi i Hasan Prishtinës

(pjesa e dytë)

*Hasan Prishtina, Njeriu që dha gjithçka për shtetin e vet, shtet që e vrau tradhtisht. ...tribun kombëtar... truri i lëvizjes kombëtare... apostull i shenjtë në shkollimin kombëtar, njeriu më i ndaluar e anatemuar nga regjimet pushtuese, diktatoriale, njeriu ndaj të cilit kemi detyrim në vënieën e figurës së tij aty ku duhet- në vendin e heronjve të historisë së ndritshme kombëtare*



Disa nga vendarët që e njohën Hasanin ishin të mrekulluar me virtytet e tij prej burri dhe patrioti. Ishte këmbëngulës dhe i pathyeshëm kur është në pyetje interesi i bashkimit kombëtar. Në kontaktet me Hasan Prishtinën u shqua familja e ushtarakut të lartë Modestus Urban dhe gruaja e tij Marie Urban, me të cilën kishin në pronësi ëmbëltoren në Vjenë, ku ajo punonte.

e tij për hapjen e shkollave shqipe e ndihmoi gjithkund ku ishte nevoja. Shembuj të tillë janë pjesë e përditshmërisë së tij.

Pasi vetë e themeloi orkestrën frymore në Vushtrri, me mjetet e tij materiale, ai dërgoi në Vjenë për të blerë instrumentet muzikore Izet Badivukun, Latif Agë Fonden dhe Abit Novolanin.

Vjena është vendi ku Hasan Prishtin përjetoi shumë kundërthënie e peripeci të vazhdueshme. Jeta e tij nuk ishte aspak e lehtë. Kundërshtarët politik të tij tani ishin kundërshtarë armiq dhe me çdo kusht donin vrasjen e tij. Për këtë qëllim u dërguan në Vjenë pesë atentatorë njëri pas tjetrit. Falë fatit dhe trimërisë së Hasan Prishtinës dhe gruas së tij, Igballe Prishtina, Vjena nuk u bë varri i Hasanit nga pesë atentatorët e dërguar nga Ahmet Zogu dhe qarqet tradhtarë të frymëzuara nga Esat Pashë Toptani. Për këtë do të shkruan gazeta shqiptare "Ora e Shqipnisë" dhe gazeta vjeneze "Neue Freie Presse" në vitin 1928. Atentatorët e dërguar në Vjenë: Pjetër Kallmati, Ibahim Lika-Lisi, Kruja, Hasan Sedi, Ibrahim Tabaku, si duket edhe i gjashti Hasan Kosova. Të gjithë këta brenda (nëntor 1927 deri në prill 1928) një viti.

Në vitin 1931 ai i shkroi nga Vjena sekretarit të përgjithshëm të Shoqatës së Kombeve, Enrik Drunandit në Romë, ku pika e parë i kushtohet shkollave shqipe: "Afër një milion shqiptarë që jetojnë në Kosovë dhe Maqedoni nuk kanë asnjë shkollë në gjuhën amtare. Ju është ndaluar të themelojnë shkolla me mjete private" theksonte Hasan Prishtina.

**(vijon)**



Hasan Prishtina (1873 – 1933)

Largpamësia e Hasan Prishtinës u pa me qëndrimin e tij se "Arsimi është shpirti i një kombi". Duke e ditur gjendjen e mjerueshme të popullit analfabet ai u angazhua me të gjitha forcat në themelimin e shkollave shqipe dhe arsimimin e shqiptarëve kudo që ndodhën. Dhe, ishte i veçantë në fushën e arsimit kombëtar. "Kontributi i tij për zhvillimin e arsimit kombëtar është i madh dhe nuk mund të gjendet krahasim, jo vetëm në historinë e popullit shqiptar, por edhe

në historinë e popujve tjerë" (M. Pirra, historian).

Ai, me këmbëngulësinë, oratorinë dhe pastërtinë si deputet i Prishtinës në Parlamentin Turk, bëri që të aktualizohet arsimit i shqiptarëve në gjuhën shqipe. Me financimin e tij privat ai hap shumë shkolla dhe i ndihmoi shumë nga ato që ishin themeluar më parë.

Duke e ditur se Vjena ishte qendër e kulturës, vendfillimi i albanologjisë, mbajti lidhje të vazhdueshme me intelektualë që vepronin aty. Në përpjekjet



### Shkruan: Vilhelme Vranari Haxhiraj, Vlorë

Vilhelme Vranari (Haxhiraj) u lind më 8 dhjetor 1944 në Kaninë të Vlorës. Pas rënies së diktaturës komuniste, rinisi punë në arsim. Kjo i dha mundësinë të shpalos talentin e saj në letërsi. Tashmë njihet si poetë, romanciere, autore e prozës së shkurtër dhe publiciste. Në 14 vite ka botuar 27 vepra letrare. Presin botimin roman, përrallë, ese -publicistikë, prozë e shkurtër, poezi, skenare për fëmijë dhe 3 përkthime nga gjuha italiane. Gjinia letrare, ku autorja ndihet më mirë, është romani. Aktualisht është kryeredaktore e gazetës "Kanina".

## Faktorët që kanë ndikuar në cungimin dhe tjetërsimin e historisë së Shqipërisë (pjesa e katërtë)

*Si çdo komb, edhe Shqipëria ka historinë e saj. Sipas mjaft autorëve të huaj ajo është një nga kombet më të lashtë të Evropës, një vend parahistorik. Për të dalë në një përfundim të tillë duhet të njihet koha e popullimit të Ballkanit jo vetëm nga Pellazgët e më pas iliro-trakët, por edhe koha e vendosjes së fiseve të tjera në Evropën juglindore. Për ta vërtetuar këtë, (kur flasim për Shqipërinë) nevojiten dokumenta të kulturës materiale, të shkruara, qendra dhe vlera materiale arkeologjike që nga lashtësia dhe deri në ditët tona, të cilat për fat ekzistojnë, por nuk janë shkruar. Ka pasur libra historike relativisht të kohëve të vona, por jo një histori e plotë e shkruar*

A i është përgjigjur gjatë asaj kohe ndonjë shqiptar, politikan, sidomos ndonjë historian (pasi duhet të mbrojtë tezën e veta mbi lashtësinë e Shqipërisë), këtij mashtruesi dhe falsifikatori të historisë ballkanike, këtij mohuesi të kombit shqiptar i cili lindi qysh në atë kohë kur njeriu njohu aftësitë e veta për transformimin e natyrës në dobi të jetës.

Problemi i fundit që ka shqetësuar mbarë atdhetarët e vërtetë, ata që e quajnë veten shqiptarë, është ndikimi grek për regjistrimin e popullsisë mbi baza etniko-fetare. Shqiptarët të detyruar nga varfëria e skajshme dhe izolimi i gjatë, me rënien e diktaturës, morën rrugët e mërgimit. Si në asnjë vend tjetër mikpritës, presioni që u është bërë emigrantëve shqiptar në Greqi, për të ndërruar emrin dhe fenë ka qenë i paramenduar. Ndaj tyre janë përdorur metoda dhe forma nga më të ultat, që nga operacioni fshesa, në dhunën fizike dhe morale duke i fyer emigrantët shqiptarë me këngë dhe fjalor rrugësh. Qëllimi i tyre ishte largpamës, sepse duke ndërruar emrin dhe fenë e shqiptarëve, ata rrisin përqindjen e minoritarëve grekë në Shqipëri. Këto janë mjetet që përdor shovinizmi për të arritur qëllimin. Ka aq shumë fakte sa nuk gjendet stomak që t'i gëlltisë. Gradualisht po i rrisin këkesat, duke ngulmuar në Autonominë e Himarës, që më pas të bashkohet me Greqinë.

Të shkruash historinë do të thotë që studiuesët dhe historianët duhet të ballafaqohen me të vërtetën e pamohueshme, ku çdo epokë të paraqitet me të mirat dhe të këqijat e saj. Shkrimi dhe rishikimi i historisë së Shqipërisë është problem madhor që duhet ta zgjidhin historianët e vërtetë, të zhveshur nga çdo lloj paragjykim apo idealizmi. Domosdoshmëri është që historinë kombëtare nuk duhet as ta drejtojë dhe as ta orientojë politika, sepse në çdo kohë secila forcë politike ngre në pedestal vlerat e veta. Historia shqiptare ka nevojë për drejtësi.

Drejtësia e një kombi nuk blihet me para dhe as dhurohet nga politikanët. Ajo vendoset duke u përballur

me të vërtetën historike, me fakte e ndodhi reale, me vendngjarjet, kohën e zhvillimit të tyre dhe duke evidentuar klasat apo shtresat shoqërore dhe personat që kanë marrë pjesë në to, pra ata që kanë qenë apo janë pjesë e historisë.

Theksoj se historia e një shteti nuk është ideale, ajo është reale dhe udhëton nëpër kohë. Që të shkruhet historia e vërtetë duhet të merren parasysh këto elementë: Ngjarja, koha kur ka ndodhur, vendi ku është zhvilluar dhe njerëzit të cilët kanë marrë pjesë në të. Gjithmonë pa harruar as shkakun dhe as pasojën. Duhet pasur parasysh që të mos shtrembërohen faktet, të mos mohohen njerëzit, as të hiperbolizohen dhe as të zvogëlohen periudhat faktike. Historia quhet e plotë dhe reale, kur paraqitet çdo etapë kohore që kalon kombi, me të mirat dhe të këqijat e saj. Jemi genie të gjalla dhe si të tillë bëjmë edhe gabime. Aq më tepër kur flitet për jetën e një populli, rrugëtimin e tij të gjatë, përshkruar në qindra e mijëra vjet. Në qoftëse njerëzimi nuk do të kishte bërë gabime dhe s' do të kishte mbajtur qëndrim të njëanshëm, atëherë historia do të ishte e shkruar si duhet. Nuk do të ishte e nevojshme që sot në shek. XXI të, shqiptarët kërkojnë të vendosin kufijtë e të parëve.

Paanshmëria në shkrimin e saj, është tregues i rëndësishme në pasqyrimin e historisë së çdo kombi. Drejtësinë mbi të vërtetën historike e vendos vetëm i vërtetshmi. Ndaj historianëve shqiptarë, që edhe sot për fajin e tyre, historia vazhdon të jetë e shtrembër, e politizuar dhe e cunuar, u del detyrë e rëndësishme ta rishikojnë, ta pasurojnë dhe ta zhveshin atë nga idealizmat dhe dogmat politike. (Vilhelme Vranari: "Rishikimi i historisë sonë është identitet kombëtar": "Pa titull ("libri Ese-publicistikë, fq.265 , v. 2011; gazeta "Standard" 11/ 9/ 2007). Duhet të kemi parasysh se edhe Franca, si djep i kulturës botërore, ka mangësi në Historinë e saj kombëtare. Edhe aty ka lindur nevoja e rishikimit dhe pasurimit të historisë. Kurse në Shqipëri është domosdoshmëri.

(vijon)



**Skruan: Prof. Dr. Lush Culaj-Instituti Albanologjik në Prishtinë**

## Rruga luftarake e Çetës së Kolë Gojanit

(pjesa e parë)

Lëvizja kaçake lindi si formë e rezistencës kundër pushtuesit të huaj. Kaçakët njihen me këtë emër qysh në periudhën turke, në shekujt XV-XVI, dhe si lëvizje kishte më tepër karakter ekonomik sesa politik. Kjo lëvizje zgjerohet gjithnjë e më tepër dhe merr formën e rezistencës politike në truallin shqiptar, posaçërisht në gjysmën e dytë të shekullit XIX, ndërsa bëhet masive pas shuarjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Fjala "kaçak", në kuptimin etimologjik, është e përbërë prej dy fjalëve turke "akti-kaçti", që do të thotë iku, u zhduk. Por fjala "kaçak" nuk jep shpjegimin se për ç' kategori të arratisurish bën fjalë, por vetëm përkufizohet si i arratisur nga pushteti. Organet shtetërore, për shkak të interesave të veta politike, e përdornin këtë terminologji në kuptim të cubit, hajnit etj., duke tentuar që në popull për këta njerëz të mos krijohet ndonjë dashuri dhe që ata të mos gëzonin përkrahje, por, përkundrazi, për ta të krijohet urrejtje.

Mirëpo, lëvizja kaçake në Kosovë ishte lëvizje e masave të gjera popullore, e mbështetur në traditat dhe luftërat e popullit shqiptar për liri kombëtare. Ishte vijim i luftës shekullore të popullit shqiptar kundër sunduesve të huaj. Kjo ishte luftë e grupeve të organizuara, të cilat në popull ishin të njohura me emrin çeta. Forma e veprimit të tyre ishte lufta guerile, ato sulmonin armikun në pikat më të dobëta, duke bërë sulme të furishme e tërheqje të shpejtë. Një ndër çetat që u dallua për aktivitetin e vet kombëtar ishte edhe Çeta e Kolë Gojanit.

Kolë Gojani është personalitet që me plot meritë i takon atributi i luftëtarit të shquar kombëtar, i cili deri në momentet e fundit të jetës luftoi me armë në dorë për jetësimin e lirisë kombëtare

### I frymëzuar me ideale lirisdashëse

U lind në vitin 1888 në fshatin Jagodë të Klinës në një familje me tradita patriotike. Nga babai Preni dhe familja e gjerë ai ishte frymëzuar që në filltet e para të jetës me ideale lirisdashëse dhe kombëtare. Që në moshë fare të re tek ai vërehej karakteri i një djaloshi të ri, tek i cili ishin brumosur burrëria, aftësia mendore e luftarake, trimëria e mbi të gjitha atdhedashuria.

Në formimin e tij patriotik një rol të veçantë luajti edhe nëna e tij Maria, e cila rridhte gjithashtu nga një familje

e njohur, Bibajt e fshatit Ranoc të Klinës. Për arsye të raprezaljeve shtetërore dhe për shkak se vëllai i Kolës, Ndou, kishte marrë pjesë në vrasjen e një serbi nga fshati Kosh i Istogut, familja e Kolë Gojanit u shpërngul nga fshati Jagodë dhe u vendos në afërsi të Gjakovës - te Mulliri i Haxhisë.

Urrejta e madhe ndaj pushtuesit turk dhe dashuria për çlirimin kombëtar ndikoi që Kola në moshë fare të re, pra në moshën 15-vjeçare, të armatohej dhe këto armë nuk i dorëzoi deri në çastet e fundit të jetës. Pas luftërave ballkanike 1912-1913 dhe pas kapitullimit të Turqisë, Kosova nuk e fitoi lirinë e kërkuar me shekuj. Ajo vetëm e ndërroi okupatorin duke u pushtuar nga serbo-malazezët. Në vazhdimësi të kërkimit të lirisë, Kola me shokë ia kthyen pushkën okupatorit të ri, i cili ishte bërë halë në sy për popullin shqiptar. Në territorin e Rrafshit të Dukagjinit ai e filloi propagandën kundër pushtuesve sebo-malazez, prandaj dhe pushteti i atëhershëm e konsideronte të rrezikshëm veprimtarinë e këtij patrioti. as shpërbërjes së Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, rezistenca kombëtare filloi të dobësohej, por ajo kurrë nuk u shua tërësisht. Në Kosovë vazhdonin të vepronin disa çeta të vogla çlirimtare, të cilat assesi nuk mund të pajtoheshin që shqiptarët të ngelin të shtypur e të persekutuar nën zgjedhën serbe.

Në mesin e atyre çetave që dalloheshin ishin: Çeta e Mehmet Delisë nga Drenica, e Jonuz Topit nga Lladrovci, e Smajl Seferit, e Kolë Gojanit etj. që kryesisht ishin të vogla. Me qëllim që t'i zhdukte këto çeta, pushtuesi serb i ndiqte ato këmba-këmbës.

Çeta e Kolë Gojanit vepronte në rrethin e Klinës, të Gjakovës dhe të Prizrenit. Disa nga bashkëluftëtarët e Kolës ishin: Palokë Kola me vëllanë Markun, Hil Ramaja, Mark Ramaja, Zef Gjioda, Tunë Nikolla, Zef Ndoja nga Xhuxha e Shqipërisë, Mhill Oroshi (Zymeri) etj. Mbështetja dhe përkrahja e popullit si zakonisht për ta nuk mungonte. Kështu, për furnizimin e kësaj çete me armë dhe me municion, një ndihmesë të veçantë e dha Pren Palushi nga Radullovcit, i cili ishte kushëri i afërt i Kolës.

(vijon)





**Shkruan: Prof. Dr. Riza Sadiku, Këshilltar në Muzeun e Kosovës**

## Kontributi i shqiptarëve të Australisë, respektivisht i Ballit Kombëtar në afirmimin e Shqipërisë Etnike (pjesa e katërt)

Në shënimet e Ditës së Flamurit, përveç që kanë marrë pjesë veprimtarët e dalluar të çështjes shqiptare në këtë kontinent, ata kanë ftuar edhe shumë personalitete të administratës australiane dhe të qyteteve ku është organizuar manifestimi të marrin pjesë, me të cilin rast janë informuar të pranishmit me historikun e shkurt të popullit shqiptar, përpjekjet e tij shekullore për çlirim dhe pavarësi, si dhe për padrejtësitë që i janë bërë nëpër kongrese dhe konferenca ndërkombëtare në copëtimin e territoreve të tyre etnike nga shtetet fqinje në krye me Serbinë.<sup>11</sup>

Shënim i Ditës së Flamurit nga mërgata shqiptare e Australisë ka qenë një rast i mirë për afirmimin dhe sezibilizimin e çështjes mbarëkombëtare, jo vetëm përmes personaliteteve të administratës australiane, por edhe përmes mjeteve të informimit. Duhet të vihet në pah se kur bëhet fjalë për veprimtarinë e devotshme të çështjes shqiptare në mërgim, profesor Vasil Andonin, ai jo vetëm që e ka mbajtur timonin e Ballit Kombëtar dhe gazetës "Flamuri", por rregullisht i ka vizituar edhe veprimtarët dhe organizatat politike të Ballit Kombëtar në Evropë, Turqi dhe SHBA. Në momentin kur veprimtarët e Ballit Kombëtar të Australisë ndiheshin si të harruar, ata në muajin prill të vitit 1976 i viziton njëri nga veprimtarët e respektuar të Ballit Kombëtar, Sylejman Meço. Mërgata shqiptare e Australisë e organizuar nga Balli Kombëtar, me gëzim të veçantë dhe në mënyrë madhështore i organizuan pritjen Sylejman Meços në Melburn. Në mesin e atyre që kishin dalë për ta pritur ka qenë edhe sekretari kraihor i Viktorisë, Xhevdet Dosti. Gjatë qëndrimit të Meços në Melburn, atë e ka kontaktuar Demir Veizi, simpatizant i Ballit Kombëtar, njeri i pasur, pronar hotelesh dhe i ka ofruar që të banojë në hotelin e tij, duke i siguruar dhomë pritje, zyrë pune, etj deri sa të qëndrojë në Melburn.

Sylejman Meço, duke qenë i etshëm dhe i mallëngjyer të takojë sa më shumë mërgimtarë dhe simpatizantë të Ballit kombëtar, nga Melburni shkon në Perth të Australisë vendoset në shtëpinë e Qamil Agushit, te vllau i Ali Agushit. Gjatë qëndrimit të tij në Perth ka mbushur 70 vjet jetë, të cilën ditëlindje jubilarë, veprimtarët e Ballit Kombëtar, në krye me familjen

Agushi ia kanë shënuar në mënyrë madhështore. Nga Perthi Meço viziton Sidnejin, të cilin me këtë rast e shoqëron ballisti veteran Mehmet Zyka. Nga Sidnej Meço viziton Brisbonën. Aty po ashtu mërgimtarët e presin në mënyrë mjaft mirë me të cilin rast Meço vendoset në shtëpinë bujare me tradita kombëtare të Rifat Hysenit. Gjatë qëndrimit të Meços në Australi, rreth tij janë mbledhur çdo ditë mërgimtarët shqiptarë për të dëgjuar rrethanat politike që janë duke u zhvilluar në atë kohë, si dhe për veprimtarinë e Ballit Kombëtar në mërgim. Gjatë bisedave të tilla, njëri nga mërgimtarët e ka pyetur Meçon se kush është më aktiv nga krerët e Ballit Kombëtar të SHBA? Meço pa hezituar është përgjegjur se më aktivi është Hafëz Jusuf Azemi, i cili me tërë qenien e tij shpirtërore punon për zgjidhjen e



çështjes Kombëtare. Meço nga Brisbane kthehet në Melburn, nga i cili qytet udhëton për në SHBA. Ndarje Meço nga mërgimtarët e Ballit Kombëtar të Australisë, edhe pse ka qenë shumë e dhimbshme dhe preکشme, ka qenë edhe shumë i frytëshëm për mërgimtarët, të cilët kanë mbetur shumë të kënaqur me bisedat e zhvilluara lidhur me veprimtarinë e Ballit Kombëtar në mërgim, sidomos në SHBA, duke ju dhënë shpresë e moral për luftën politike që bënte Balli Kombëtar në mërgim sipas kërkesave të kohës, për afirmimin dhe ndërkombëtarizimin e çështjes mbarëkombëtare, si në administratën amerikane, ashtu edhe në organizatat ndërkombëtare. Takimet e veprimtarëve të Ballit Kombëtar të Australisë me Sylejman Meçon u kanë lënë mbresa të thella dhe të pa harruara, të cilat i kujtojnë me pietet edhe sot e kësaj dite.<sup>12</sup>

(vijon)

<sup>11</sup> Dr. Riza Sadiku, Kontributi i Lidhjes Kosovare në afirmimin e çështjes shqiptare në mërgim, E djathta Shqiptare në Mbrojtje të Shqipërisë Etnike 3, Prizren-Shkodër 2006, fq. 204-214

<sup>12</sup> Petrit Kello, veprimtar i devotshëm i Ballit Kombëtar dhe i çështjes shqiptare në Australi., Shënime janë përgaditur nga dora e tij, të dërguara me e-mail më 30 prill 2009, Brisbane, Australi.



**Shkruan: Pjeter Logoreci, Vjenë**

## Pranvera e Demokracisë

(pjesa e tretë)

*Në përkujtim të grevës kombëtare të urisë së përndjekurve politik në Tiranë me 1991*

Po kështu kam të gjallë në kujtesë edhe vizitat e shumta të shoqatave nga rrethet e ndryshme të vendit, politikanëve, studentëve, grupeve të ndryshme për të drejtat e njeriut e ish-shokëve, bashkëvuajtës të burgut.

Në mesin e ish të burgosurve kishte edhe persona që rridhnin nga ish blloku, fëmijë të anëtarëve të byrosë apo të anëtarve të komitetit qendror të partisë së punës. Pra, ministrave komunistë të cilët ranë vetë viktimë në burgjet që baballarët e tyre sajuan për njerzit e thjeshtë. Rasti e solli që të dëgjoj fjalë të mira për sjelljet e tyre në burg, por edhe nganjëherë pashë të kishte alergji e reagim negativ.

Aty nga dita e 8-të e grevës erdhën për të na vizituar një grup deputetësh dhe ministrash të qeverisë të stabilitetit, për të dhanë mesazhin që “po përiqeshin” të analizojnë kërkesat tona, e ndodhi që një ministër, djalë nga familjet komuniste të ish bllokut, u flak dhunshëm nga grevistët, jashtë mbi asfalt....

Vetëmohimi për të qar grevën deri në arritjen e plotësimit të kërkesave u bë motivi kryesor i qëndresës të ish-burgosurve, edhe pse ishin të lodhur nga vuajtjet e burgut e nga mungesa e ushqimit gjatë grevës. Pati dhe raste që grevistë dërgoheshin në spital për trajtim, por që me këmbëngulje kërkonin të ktheheshin pranë shokëve.

Çdo pasdreke qindra qytetarë të Tiranës mblidheshin në oborrin para sallës sportive në shenjë solidariteti me grevistët. Shpesh ndodhte që të hidheshin parulla kundër qeverisë, kur nga dritaret e palestrës Vitor Martini apo Vladimir Xhelo njoftonin për gjendjen ditore të grevistëve.



Ditët kalonin plot me rreziqe të dukshme në shëndetin e pjesmarrësve, por prej shtetit vetëm heshje... Dinosauri komunist Ramiz Alia, në rrokullisje e sipër, synonte përsëri jetë njerzore e gjak të pafajshëm. Ndonjë deputet i opozitës, jo me prejardhje komuniste, e që i njihte rrethanat e jetës së burgut si Pjetër Arbnori, përiqej të imponohej te shteti, por pa rezultat.

Osman Kazazi, shtëpia e të cilit ishte bërë bazë qëndrimi e informacioni për ish-të burgosurit e familjarët e tyre, ishte i angazhuar me kontaktet e bisedimet për realizimin e kërkesave me politikën. Ishte dita e 11-të. Gjendja shëndetsore dhe higjienike në sallën e grevës ishte përkeqësuar jashtë çdo kufiri njerëzor, kur një lajm i mirë ngrohu shpirtërat e trazuar të grevistave. Qeveria e stabilitetit kishte vendosur të marrë parasysh kërkesat e të përndjekurve. Por rezultati konkret i lëvizjes sonë ishte rrëzimi më pas i qeverisë neokomuniste së stabilitetit dhe dalja e dekretit për zgjedhje të reja në shkurt 1992 ku demokracia fitoj bindshëm.

Pas 10 ditë greve, parlamenti miratoi njëzëri një ligj gjysmak, për të cilin të përndjekurit kanë pasur dhe kanë ende, edhe sot, shumë pakënaqësi duke e ndjerë veten të papërfaqëuar.

Shpresoj që greva KOMBËTARE E ISH-TË PËRNDJEKURVE POLITIK, në vazhden e lëvizjeve anti-komuniste, do të zë vend në mes të ngjarjeve të rëndësishme që janë të ekspozur në muzeun kombëtar në seksionin e luftës kundër komunizmit.

**(fund)**



**Përmbodhi: Zef Ndrecaj, Schladming/Austri**

## Mësuesi i Popullit, Ndreçë Ndue Gjoka

(pjesa e parë)

Mirdita gjatë shekujve u shtyp nga shumë pushtues mizor. Posa ajo merrte veten, rritej, zhvillohej dhe lulëzonte, prapë binte në pozitë të vështirë. Por ajo kurrë nuk u gjuhëzua. Malësorët trima të Mirditës kurrë nuk i lëshuan armët për të luftuar për tokën, atdheun dhe lirinë e Shqipërisë.

Ky përshkrim i Mirditës është i tërë i njëjtë me përshkrimin e jetës dhe veprimtarisë së kolosit, atdhetarit, pishtarit të dijes, mësuesit të shkronjave dhe mësuesit të popullit, Ndreçë Ndue Gjoka. Prandaj çdo përshkrim i Mirditës është po ai përshkrim i këtij kolosi të madh, i cili kurrë nuk u gjuhëzua, as nga pushtuesit, as nga varfëria, për të ndritur mbi gjitha kullat dhe shkrepat e Mirditës. Prandaj në historinë e Mirditës dhe Shqipërisë vend tejet të rëndësishëm zë mësuesi Ndreçë Ndue Gjoka.

Ndreçë Ndue Gjoka u lind më 1919 në fshatin Bisak të Fanit (rrethi i Mirditës). U rrit në kushte jashtëzakonisht të vështira, sikurse shumica e moshatarëve të tij të varfër. Këtij vogëlushi, për fat të keq, i ra të rritet në kushte të mjerimit që të përkujtonin legjendën e Migjenit-atë të misrit: mungesën e vajgurit, të kripës, të opingave... Kalitja e tij me tërë virtytet e një burri të kohës u bë në Bisakun e tij të lindjes që ishte një kështjellë odash e trimërishtë, kreshnikësh dhe bujarisë. Ai posa i mbushi moshën shtatë vjeçare sikur u mishërua me shkollën dhe alfabetin i cili ju bë rrugëpërshkrim i jetës së tij për të ju mësuar të tjerëve. Kështu Ndreçë Ndue Gjoka u vendos me banim në konviktin shkollor që mbante emrin “Mirdita” në Orosh, çerdhe kjo që grumbullonte nga tetë fëmijë për bajrak, domethënë rreth dyzet prej tyre, të cilët qenë fëmijë fisesh nga derë të njohura. Pra, Ndreca mësimit e para të shkollimit fillestar i mori në Orosh, mësime të cilat shndërriten gjatë tërë jetës dhe në krijimtarinë e tij. Këtu ai vuri kontaktet e para si fëmijë me Bardhok Bibën, me të cilin nuk u nda deri në vdekje.

Mësuesit e kësaj shkolle ku Ndreca i merrte dituritë, vërejtën se ky vogëlush ishte inteligjent, i zgjuar dhe i shkathtë. Shkruante bukur dhe zhvillonte me kujdes në veçanti lëndën së aritmetikës. Ai kishte fituar një besim të veçantë tek mësuesit të cilët bënë çmos që ai t'i vazhdojë mësimit e larta në shkollën normale të Elbasanit.

Kështu Ndreca përpos që angazhohej me gjithë shpirt në procesin edukativo-mësimor mjaft aktiv ishte edhe në aktivitetet të tjera jashtë. Duke qenë nxënës i dalluar, i kujdesshëm dhe i shkathtë në punë, ai shumë shpejt u afirmua në mesin e shokëve të klasës dhe të shkollës.

Shkolla Normale e Elbasanit atëherë drejtohej nga pedagogu, studiuesi dhe atdhetari i devotshëm, Aleksandër Xhuvani, dhe disa tjerë të cilët ndikuan dukshëm në ngritjen e Ndreçës si individ me përcaktime të qarta. Kur Ndreca ishte nxënës shkolle këtu edhe u formua shoqata atdhetare “Naim Frashëri” në të cilën ai me përkushtim të madh punoi.

Në këtë shkollë e njohur për tradita atdhetare dhe vatër e shquar e përgatitjes së intelektualëve dhe përhapjes së dritës dhe të arsimit në popull në vitin 1939 Ndreca diplomoi si mësues.

Po atë vit ai largohet nga Elbasani, i aftësuar për ta vazhduar detyrën e shenjtë të mësuesit me një nivel shkencor dhe pedagogjik mjaft të mirë. Ai në shkollën normale të Elbasanit kishte përvetësuar mjaft pikëpamje të avancuara të kohës, të psikologjisë dhe të pedagogjisë së Aleksandër Xhuvanit, drejtorit, shkencëtarit dhe pedagogut të kësaj shkolle.

Ndreçë Ndue Gjoka në vitin 1940 emërohet mësues në fshatin Linaj të rrethit të Shkodrës. Ai edhe pse në moshën njëzet vjeçare ngjitej bjeshkëve me çantën e mbushur lapsa dhe fletore. Me ata pak lapsa e fletore ai kalonte maleve nga fshati në fshat, ndizte zemrat e vogëlushëve malësorë, duke ju mësuar shkrim-leximin.

Ai mbledhte vocërrakët edhe në kasollet e mbuluara me kashtë. Në dërrasën e nxirë me tym pishe ai me shkronjat e tij do të shndërriste si rreze dielli për ta mbuluar errësirën. Dhe, nga bashkimi i atyre shkronjave lindte një fjalë e madhërishtme si shkëlqimi i diellit.

Pas punës njëvjeçare në shkollën fillore në Linaj të rrethit të Shkodrës, me urdhrin e Ministrisë së Arsimit së Shqipërisë, bashkë me shumë mësues të tjerë nga Shqipëria edhe mësuesi Ndreçë Ndue Gjoka u emërua mësues në shkollat kombëtare në Kosovë.

**(vijon)**

## Kulturë

**Shkruan: Prof. Dr. Zymer Ujkan Neziri**

Zymer Ujkan Neziri lindi më 6 nëntor 1946 në Siparant (ose Zahaq) të Pejës. Kreu Fakultetin Filozofik të Prishtinës (1971) ku mbrojti magistraturën (1979) dhe doktorurën (1995). Nga viti 1967 merret me mbledhjen e folklorit, sidomos të epikës legjendare dhe të epikës historike. Pos tjerash ka realizuar edhe dy qëndrime studimore në SHBA, në Universitetin e Harvardit (shtator-tetor 2002 dhe shkurt 2007) dhe një në Austri, në Vjenë (nëntor 2005). Në Vjenë, në cilësinë e bursistit të Ministrisë Federale të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës të Qeverisë së Austrisë, ka realizuar projektin “Dorëshkrimet shqip të folklorit të Maksimilian Lambercit (Maximilian Lambertz)”, në Akademinë e Shkencave të Austrisë-Arkivi.

**Eposi i kreshnikëve: monument i trashëgimisë kulturore shqiptare**

(pjesa e katërt)

**7. Eposit të Kreshnikëve dhe fillet e mbledhjes** ishte Gustav Majeri i pari që botoi këngën e parë, fragment, *Tha, drit ka dal e dielli nuk ka ra*, më 1897,<sup>13</sup> kurse mbledhësit dhe botuesit e parë shqiptarë të Eposit të Kreshnikëve janë konsideruar Gaspër Jakova-Mërturi, kënga *Të lumët na për të lumin Zot*, më 1904<sup>14</sup> dhe Nikollë Ivanaj, kënga *Vuko Harambashi dhe Hajkuna e Dezdar Osman Agës*, më 1905,<sup>15</sup> ndërsa shqetësimin e intelektualëve shqiptarë të kohës e bart, në emër të disa brezave, prifti ynë Shtjefën Gjeçovi, më 1905.<sup>16</sup> Mirëpo, pas Majerit, mbledhës i parë këngës së kreshnikëve është Hasan Fejzullahu, që më 1901 mblodhi këngën «Gjergj Elez Alia» dhe që është edhe përkthyes i saj në serbisht.<sup>17</sup> Mbledhës të Eposit të Kreshnikëve ndërmjet dy luftërave botërore qenë: Bernardin Palaj, Donat Kurti, Karl Gurakuqi, Filip Fishta, Hasan Reçi etj. Sot, nga mbledhësit e huaj dallohet Koleksioni me këngë të kreshnikëve i Allbert Llordit (Albert Lord), i viteve '30, që ruhet Universitetin e Harvardit. Pastaj, janë të përmendur blenjtë I e II (1937) dhe IV (1939) të *Visareve të Kombit*, bleu *Zana popullore* (Kasem Taipi), si dhe revistat *Hylli i Dritës* (Gjergj Fishta), *Leka* (organ i shoq. *Leka*), *Edukata e Re* (S. Pejani). Brezi i viteve '20-'30 të shekullit të kaluar u parapriu mbledhësve dhe botuesve të njohur të këngëve të Eposit të Kreshnikëve në gjysmën e dytë të shekullit XX: Qemal Haxhihasani, Gjergj Komnino, Anton Çetta, Zymer Neziri etj.

**7.1. Përhapja e Eposit sot**

Eposi i shqiptarëve është ndër eposet e fundit në Evropë dhe ende bën jetë aktive në shumë krahina etnogeografike të Kosovës: Rugovë, Rrafsh i Dukagjinit, Llapushë, Drenicë, Shalë e Bajgorës, Rrafsh i Kosovës, Llap, Gallap, Karadak. Ende bën jetë aktive edhe në shumë krahina etnogeografike të Shqipërisë: Malësi e Madhe, Shalë, Shosh, Nikaj, Mërtur, Malësi e Gjakovës, Lumë, Pukë, Mirditë, Kurbin, si edhe në shumë krahina etnogeografike të viseve shqiptare në Maqedoni: në rrethinat e qyteteve Kumanovë, Shkup, Tetovë, Gostivar, Kërçovë. Gjithashtu është gjallë në disa krahina etnogeografike të viseve shqiptare në Serbi: Preshevë, Bujanovc, Medvegje dhe pjesa e Sanxhakut të Pazarit në Serbi. Po ashtu jeton edhe në shumë krahina etnogeografike të viseve shqiptare në Mal të Zi: Kojë, Triesh, Grudë, Hot, Krajë, Shestan, Anë e Malit, Plavë e Guci, rrethina e Rozhajës dhe pjesa e Sanxhakut të Pazarit në Mal të Zi.

<sup>13</sup> Gustav Meyer, *Albanesishe Studien*, VI, Wien, 1897, f. 52.

<sup>14</sup> Prof. D. Gaspar Jakova-Merturi, *Gramatica della lingua albanese*, Frascati, 1904.

<sup>15</sup> *Gaz. Shpnesa e Shqypëniis (1905-1908)*, Dubrovnik, Kroaci.

<sup>16</sup> Shtjefën Gjeçovi (1874-1929), meshtar, mësues, folklorist, etnolog, arkeolog, historian etj. E vrau pushteti serb.

<sup>17</sup> Kënga u botua serbisht, më 1932, nga profesori T.R. Gjorgjeviq, në *Naš narodni život*, VI, Beograd. E këndoi i ati i Hasanit, lahutari Fejzullahu Merova, nga katundi Merovë, rrethi i Toplicës.

**7.2. Rreziku i zhdukjes së Eposit**

Meqenëse epika legjendare është në fazën e zhdukjes së saj përfundimtare si krijim i gjallë gojor dhe duke marrë parasysh se populli shqiptar, që jeton në viset e veta veriore, kryesisht në viset kodrinore-malore, ende e mban gjallë këtë krijim poetik, është e domosdoshme që në këto momente të skajshme historike të ekzistencës së këtij lloji, me anën e një ekspedite kërkimore-shkencore të organizohet mbledhja në formën audiovizuale, sistemimi, analizimi, studimi e botimi i tyre dhe kjo pasuri kombëtare kulturore dhe artistike të mbetet një burim studimi shumëdisiplinar për gjeneratat e ardhshme të shkencëtarëve. Duke e mbledhur dhe duke e studiuar Eposin e Kreshnikëve ne shpresojmë të arrijmë që këtë pjesë të thesarit kulturor ta ruajmë përfundimisht nga zhdukja dhe, në anën tjetër, të mundësojmë që edhe studimet e disiplinave të tjera gjuhësore, sociokulturore dhe etnopsikologjike të kenë një bazë më të mirë të studimit në të ardhmen.

**8. Mbledhja e Eposit të Kreshnikëve**

Mbledhja, sistemimi, analizimi dhe botimi do t'i përshijë tri format e ekzistencës së epikës legjendare shqiptare: Formën e kënduar, faza e fundit e ekzistencës së saj, që përfshin territoret perëndimore të Kosovës, veriun e Shqipërisë dhe jugperëndimin e Malit të Zi. Formën e recituar, faza fillestare e zhdukjes, që shtrihet në viset jugore dhe lindore të Kosovës, në Luginën e Preshevës dhe në pjesën veriore të Shqipërisë së Mesme. Formën e rrëfimit, faza përfundimtare e zhdukjes, që shtrihet në disa pjesë të Kosovës, të anës veriperëndimore të Maqedonisë dhe të Shqipërisë së Mesme.

**Përfundim**

Eposi i Kreshnikëve, lloji i poezisë epike legjendare shqiptare, është nga njësitë më të lashta të krijimtarisë shpirtërore të popullit shqiptar, në rrezik, sepse, fatkeqësisht, është para zhdukjes, kurse mbledhja e tij urgjente në pesë shtete të Ballkanit është një nevojë e domosdoshme në fillim të këtij mijëvjeçari. Për vlerat artistike të këtij lloji të poezisë epike legjendare janë shkruar artikuj dhe studime të shumta nga studiues shqiptarë dhe të huaj në dy shekujt e fundit. Është konstatuar se vlerat artistike janë të shkallës së lartë. Eposi i Kreshnikëve është ndër pikat më të ndritshme evropiane dhe botërore të folklorit burimor sot. Me të drejtë bën të thuhet se Eposi i Kreshnikëve është ndër shtyllat kryesore të trashëgimisë shumëshekullore të shqiptarëve. Eposi, krahas polifonisë, gjamës, xhubletës dhe Kanunit, është monument i lashtë etnokulturor, me të cilin shqiptarët mund të krenohen para botës. Ndonëse deri më sot janë shënuar rreth gjysmë milioni vargje të këngëve e të motërzimeve, për mbledhësit e Eposit të Kreshnikëve, sidomos në qendrat e mëdha studimore në Tiranë e në Prishtinë, ende nuk ka përfunduar puna.

(fund)





**Shkruan: Lulzim Bazhdaraj, student i magjistraturës në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Njerëzore-dega histori, në kuadër të Fakultetit Lyon, në Francë**

## Lahuta ndër instrumentet më të vjetra muzikore në Evropë dhe në Ballkan

### Origjina në shqip e emrit “Lahuta”



Lahuta është një instrument i lashtë muzikor që përdoret në qendër dhe në jug të Evropës (Ballkani sot, Iliria e lashtë). Ky instrument ka disa emra në varësi të origjinës së tij. Lahuta për Shqipërinë. Gusle për Kroacinë, Bosnjën, Malin e Zi, Serbinë dhe Rumaninë. Guzla për Bullgarinë dhe Maqedoninë, etj. Ky term i referohet një lloj të violinës bërë në një copë të vetme të drurit, i përbërë prej qimeve të kalit (nga jaka apo bishti i kalit). Kjo nuk duhet të ngatërrohet me lahutë Ruse (gusël), as me (afat) Çeke për Housle-violinë.

Ky instrument është shoqëruar gjithmonë me muzikë popullore, këngë, poezi dhe veçanërisht epikë. Muzikantëve të mësuar për të luajtur me këtë instrument muzikor ju është dhatur shumë punë dhe koncentrim i lartë gjatë përdorimit të lahutës. Lahutari e mban instrumentin e tij vertikalisht midis gjunjëve, ndërsa gishtat e dorës së majtë mbi litar duke manipuluar me gishta që i jep një melodi të larmishme. Tingulli prodhohet duke përshkuar me hark bishtin e lahutës, ndërsa akordet ndërrohen duke prekur bishtin me gishtat e dorës tjetër.



*shtetet ku përdoret instrumenti muzikore lahuta*

### Materiali dhe format e lahutës

Prodhimi apo fabrikimi i Lahutës është komplekse sepse kërkohet nga një dru i vetëm që të prodhohet. Druri duhet të jetë kryesisht nga panja, por gjithashtu mund të jetë punuar nga druri tjetër si: druri verr, etj. Lahuta është si një top i mbuluar me lëkurë dhie (cilësi më të mirë) apo lopë (cilësia më e ulët). Harku i lahutës është projektuar nga një degë e thanës (emri i një peme tipike

e Ballkanit) dhe rreth 40 qimeve të kali të mbledhura së bashku si një varg. Shpohet janë të montuara dhe koka. Për të luajtur këtë instrument ju duhet të përdorni një hark. Lahuta është e zbukuruar shpesh me simbolet e kulteve e lashta si kokat e gjarpër, dhi ... ose figura fetare, historike, kombëtare. Muzika që është luajtur në lahutë është frymëzuar nga varietetet kulturore, të tilla si poezi epike. Instrumenti është identik me disa ndryshime të vogla në dizajn në varësi të saj zone dhe krerët e skulpturat në instrument ilustrojnë territoret e tyre. Forma dhe madhësia e trupit të lahutës janë të ndryshme, varësisht nga prodhuesi dhe kërkesat e personit që luan me të. Ajo duhet të jetë e përshtatshme për madhësinë e muzikantit. Kjo është arsyeja pse disa Lahuta kanë ëdiths të ndryshme dhe gjatësisë.

### Lahuta në territoret shqiptare

Për shqiptarët në Ballkan, kudo që ata jetojnë, ky instrument muzikor është i veçantë dhe autentik. Kohët e fundit po punohet që që të mos lejohet që këtë instrument me vlerë ta rrezikojë ardhja e muzikës moderne dhe instrumentet.



*Lahutari pikuar nga piktori Hasbi Gashi*



*Lahutar nga Merturi Puka.*

Gjatë festimeve me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë u mbajt një manifestim me karakter kombëtar me prezantimin e këtij instrumenti nacional në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Shkencave me qëllim të krijimit të një ekspozite etnografike me objekte unike në mitologjinë shqiptare.

Ekspozita u mbajt në maj të vitit 2012 në sallat e Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë. Theksi u vu mbi lahutën si përfaqësues instrumentale e muzikor i trashëgimisë kulturore shqiptare dhe shpirtërore. Kjo ekspozitë ka paraqitur mbi 30 lloje të lahutave që u përkasin epokave të ndryshme. Disa nga instrumentet erdhën nga Muzeu Kombëtar i Shqipërisë dhe disa u huazuan nga mbledhësit privatë. Kjo ngjarje shënoi përfundimin e përgatitjes së dosjes së propozuar për njohjen nga UNESCO dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore si lahutë shqipe.

## Faqja Poetike



### Shkruan: Shefki Ollomani

Shefki Ollomani u lind në vitin 1959 në fshatin Tuhin të rrethit të Kërçovës. Shkollën tetëvjeçare e ka kryer në vendlindje, kurse shkollën e mesme në gjimnazin “Zef Lush Marku” në Shkup. Ka të kryer 3 vite të Fakultetit Juridik në Prishtinë. Merret me poezi dhe publicistikë. Deri tani ka botuar dhjetë libra.

#### Të dua vetëm ty

E kam Qiellin  
dua vetëm një Yll.  
E kam Detin,  
dua një Pikë Uji.  
E kam Botën,  
të dua vetëm Ty.

Ti je Yll që ndriçon,  
Ti je Det që dallgëzon,  
Ti je Ujë që gurgullon,  
Ti je Ajr që frymon,

Për Ty, o Yll, oj Dritë!  
Vdes e ngjalle ditë-përditë.

#### Je

JE - Diell i zemrës sime,  
Nëpër brenga e shqetësime.

JE - Hënë e shpirtit tim,  
Nëpër flakë e nëpër tym.

JE- Trëndafil i kuq në verë  
Që nuk vyshkesh asnjëherë.

JE - Hënë e plotë në terr të natës  
JE-Yll polar në mes  
t'shtrëngatës.

#### Zemrat tona

Zemra ime, zemra jote  
Porsi lulet e kësaj toke.

Zemra jote, zemra ime  
Ndezen, shkrihen n'përqaftime.

Zemrat tona, rreze Dielli  
Yje të kuq të këtij Qielli.



### Shkruan: Eduard Frrokaj, Gjakovë

#### Lirikë me shi për Martin Camaj...

Në atdhe fluturojnë aeroplanë dhe kujtime  
e sjellin kumtin, fjalën, plagën  
pa trimin...  
sa peshon fjala shqipe  
në lëkurë të moteve,  
në gegnishte të murgut,  
kujtimet e trishta të fisit,  
sa peshojnë,  
burrë Malsie, midis Bavarie...


E po kur të del pranvera sivjet,  
pranvera e këtij moti,  
atje moj malsore, atje mori Shkodër,  
në brinjë të tokës së plagueme,  
kemi me e lëshu grurin,  
po si mbillet fara e gjuhës shqipe, mjeshtër...  
në tokë të papunueme...

Na do të vijmë një ditë,  
kur të na gjuan reja për së kthjellti  
për mëkatet tona,  
po do të vijmë një ditë,  
të pijmë birrë Bavarie,  
shenjave të Europës,  
do ta kërkojmë trupin e poetit,  
në lirikë me shi,  
ku këndon qyqja në Dukagjin ,  
a në varreza të Mynhenit...

Në atdhe nuk ka vend për poet,  
të vramë reje, të shituem diktature,  
po sa kushton atdheu,  
e si mbillet fara e gjuhës shqipe,  
pash të lumin zot mjeshtër...  
sa kushton atdheu !

Shkruan: Besim Xhelili, Vjenë

## Vështrim mbi romanin “Udhëkryqe misionesh” të autorit Driton Smakaj



Romani “Udhëkryqe misionesh” paraqet diçka e re në letërsinë tonë. Në fillim më merakosi trashësia e tij, por duke e shfletuar faqe për faqe, ngjarja më tërhiqte gjithnjë e më shumë në thellësinë e saj. Vepra i përngjan filmave krimi që kemi parë në kinema dhe televizor, por është një e vërtetë nga, të shpresojmë luftërat e fundit në Ballkan. Fatkeqësisht një prerje e dyndjeve politike dhe luftarake nga trojet tona. Dhe mendimi im që nga fillimi ka qenë që kjo ngjarje duhet të arrijë një ditë e të realizohet si film televiziv.

Autori duke tërhequr lexuesin nëpër mendimet e tij dhe nëpër vende të ndryshme të botës, që japin përshtypjen e një realiteti tragjik e të hidhur, e bën interesante këtë rrugëtim. Lexuesit i vijnë para syve skena të ndryshme. Herë trimëruese e herë të dhimbshme. Kështu, do të shohim se si rrugëve qëndrojnë njerëz të vdekur dhe të masakruar, pa kurrësyr as edhe foshnjat e vogla, dhe pak më vonë disa djem që dalin dhe i bëjnë sulm ballë përballë armikut, duke mbrojtur popullsinë e pafajshme civile.

Personazhi kryesor Lumi, është një djalë i ri simpatik dhe që e do lirinë. Ai nuk kursen as edhe më të shtrenjtën që ka, pra jetën e tij, vetëm t’i shërbejë atdheut. Ai është i kyçur në qarqet e agjentëve të UÇK-së dhe në kontakte e udhëtime

të shumta nëpër botë. Fillimin ngjarja e ka me një telefonatë që ai merr dhe më pastaj duhet të nisët për në misionin e tij në Tiranë. Ai nuk e ka të lehtë t’i dëshifrojë mesazhet, por kjo e shtyn në mendime. Personi të cilin ai u desht ta mbrojë gjendet i vdekur, dhe ai zbulon vrasësit, në target për në Itali. I ndjek ata pa u hetuar aspak dhe e përfundom misionin e marrë përsipër.

Dashuria për vajzën arbëreshe si dhe premtimi që ia dha asaj e detyron Lumin pa ndalur të mendojë që një ditë të kthehet tek ajo në Itali dhe të vazhdojë një jetë të qetë. Pas disa lëndimeve të rënda që merr në front dhe duke e ngatërruar me një ushtar italian, KFOR-i italian e merr dhe e dërgon urgjentisht në një spital në Itali. Pak më vonë zbulohet identiteti i tij i vërtetë. Pastaj vjen edhe arbëreshja Elisa dhe e takon në spital.



### Driton Smakaj, autor

U lind më 26 prill 1979, në fshatin Abri e Poshtme, komuna Skënderaj. Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Shkollën e mesme, vitin e parë dhe të dytë i kreu në gjimnazin “Luigj Gurakuqi” në Klinë, ndërsa vitin e tretë dhe të katërt në gjimnazin “Skenderbeu” në Drenas. Studimet universitare në fakultetin ekonomik në Prishtinë i filloi në vitin e “nxehtë” më 1998, por që në ndërkohë ishte aktivizuar në luftën çlirimtare për një Kosovë të lirë. Si rezultat i kësaj vazhdon studimet vetëm nga shtatori i vitit 1999 dhe në shkurt të vitit 2003 diplomon në fakultetin ekonomik me temën “Instrumentet e sigurisë në marrëdhëniet e biznesit ndërkombëtar”. Studimet postdiplomike për “Zhvillim të Qëndrueshëm” i vazhdon në Universitetin më të vjetër të botës, në Univesitetin e Bolonjës në Itali. Pas studimeve

postdiplomike kthehet në Kosovë dhe punon në një Bankë, në departamentin e marrëdhënieve ndërkombëtare, në mbështetje të biznesit ndërkombëtar përmes instrumenteve të ndryshme bankare. Për shkaqe private dhe pune në korrik të vitit 2006 vendoset në Hungari, ku edhe sot jeton dhe vepron. Punon për një kompani multinacionale, lider botëror në sektorin e energjisë-ExxonMobil Corporation.



## Sport

LIGA SHQIPTARE E  
FUTBOLLIT NË AUSTRI

ALBANISCHE FUSSBALL LIGA IN ÖSTERREICH

**Fillon Kampionati i Futbollit  
në Lshf.A****Më 07.04.2013  
11.30 – 16.30 Uhr****Franz Koci Strasse Nr1  
1100 Wien ( becirku 10).**

Me 13 shkurt 2010 u themelua Liga Shqiptare e Futbollit në Austri (LSHFA). Qëllimi i kësaj iniciative ka qenë dhe do të jetë që sporti shqiptar, sidomos futbollit në Austri, të prezantohet në mënyrë të organizuar dhe profesionale, si dhe të tregohet disiplinë dhe cilësi sportive. Në turne që zhvillohen kohë pas kohë prezentohen me programe të pasura kulturo-artistike edhe shoqata të ndryshme shqiptare. Për më shumë informacione vizitoni web-faqen e LSHFA:

[www.futbollishqiptar.eu](http://www.futbollishqiptar.eu)

## Liga Shqiptare e Futbollit në Austri

## P E T I C I O N

Vjenë , 01.03.2013

Liga Shqiptare e Futbollit në Austri (LSHFA) në kuvendin saj të fundit, ndër të tjera, mori vendim që të përpilojë një peticion drejtuar OKB, FIFA dhe UEFA për pranimin e Federates së Futbollit të Kosovës (FFK) në FIFA dhe UEFA. Peticioni ka për qëllim senzibilizimin e opinionit ndërkombëtar në lidhje me izolimin e padrejtë që po i bëhet futbollit , futbolldashësve, lojtarëve dhe gjithë puntorëve sportivë në Kosovë. Republika e Kosovës, gjegjësisht Federata e Futbollit të Kosovës, si pasojë e vendimeve të FIFA dhe UEFA, e që aspak nuk kanë të bëjnë me sportin, në veçanti me futbollin, është izoluar në mënyrë të padrejtë. Ne mendojmë se lënia e FFK jashtë organizmave sportiv, siç janë FIFA dhe UEFA nuk i ndihmon futbollit. Për më tepër, nuk mund të jetë shkak mosqenja anëtar i OKB arsye që Kosova të mos jetë prezente në arenën ndërkombëtare të futbollit.

Edhe pas katërbëdhjetë vjet lirie dhe pesë vjet nga shpallja e pavarësisë së shtetit të Kosovës FFK nuk arriti të bëhet anëtare e FIFA dhe UEFA. Ne i dimë lobimet të cilat kundërshtojnë një pranim të tillë. Ato vijnë nga një shtet që katërbëdhjetë vite më parë bëri gjenocid duke vrarë edhe futbollistë dhe shumë punëtorë futbollit në Kosovë. Prandaj na duket absurde që një lobim i tillë të gjejë miratimin e sidomos udhëheqësit të UEFA, Michel Platini.

Jemi të bindur se peticioni është një mjet përmes të cilit do të tentojmë që çështjen e FFK ta ndihmojmë edhe ne në mërgatë.

## Sukseset e ekipi i futbollit SV Albania



Në verë të vitit të kaluar në Vjenë u themelua edhe klubi i futbollit SV Albania. Ekipi garon në ligën e katërt të Austrisë. “Sivjet SV Albania do të jetë befasia e kampionatit” deklaroi trajneri Lulzim Bojku



*Klubi i Futbollit*



Lahuta e Malësisë

Vjenë



## Klubi i futbollit “Lahuta e Malësisë”-Vjenë i gatshëm për sezonin e radhës në LSHFA



Vjenë, 27 janar 2013: -Me pjesëmarrjen e 14 anëtarëve u mbajt mbledhja e parë për këtë vit e kryesisë së klubit në futboll të vogël, Lahuta e Malësisë. Në takim u diskutua për përgaditjet për sezonin e ri të Ligës Shqiptare në Futboll në Austri (LSHFA). Klubi Lahuta e Malësisë ka paraqitur aplikimin zyrtar pranë LSHFA për të marrë pjesë edhe sivjet në garat e LSHFA në sezonin 2013. Klubi ka kontaktuar me pjesën më të madhe të lojtarëve që u angazhuan gjatë vitit të kaluar dhe ka përpiluar listën fillestare të lojtarëve të saj për këtë vit. Pritet që donatorët kryesorë të klubit do të vazhdojnë të jenë, si dhe deri më tani Lush Neziri, shtypshkronja “ALBA KOPIE”, agjensioni “Luli Reisen”, Fadil Tafili, etj.



## U zhvillua turneu i shahut për nder të 5 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës<sup>18</sup>

Vjenë, 23 shkurt 2013:-Nën organizimin e shoqatës kulturo-sportive “Arbëria” në ambientet e restorantit “Cafe Timi” në Vjenë, u zhvillua turneu i shahut për nder të 5 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Në këtë aktivitet morën pjesë 14 lojtarë, ndërsa për mbarëvajtjen e turneut u përkujdes gjyqtari profesionist i shahut, Gerhard Schulz.

Fillimisht, të pranishmit i përshëndeti kryetari i shoqatës “Arbëria” Kadri Berbat, i cili në mënyrë të veçantë foli për rëndësinë e këtij manifestimi. Më pas, Anton Marku, këshilltar në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Austri në emër të këtij institucioni ju adresua pjesëmarrësve me një fjalë rasti. Të pranishmëve po ashtu ju dëshiroi mirë se ardhje edhe nënkryetari i shoqatës “Arbëria”, Xhevat Xhemali.

Loja u zhvillua me sistemin zviceran, me shtatë xhiro, ndërsa fitues u shpallën:

1. Agron Çika
2. Fatos Krasniqi
3. Kadri Berbat



Në këtë turne i pranishëm ishte edhe Besim Xhelili, kryetari i shoqatës kulturore “Aleksandër Moisiu” nga Vjena. Fituesit u shpërblyen me kupa dhe medale, ndërsa për të gjithë pjesëmarrësit shoqata kulturo-sportive “Arbëria” ndau mirënjohje. Ky është turneu i dytë mbrenda një periudhe kohore prej tre muajve. Me 10 nëntor 2012, e njëjta shoqatë kishte organizuar turneun e shahut për nder të 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.

Klubi i shahut “Arberia” në Vjenë çdo ditë e më shumë po përfiton miq dhe simpatizues të cilët po shprehin gatishmërinë e tyre që në forma të ndryshme të ndihmojnë promovimin e këtij sporti mes mërgimtarëve tanë edhe në Austri.

Si dhe herave të kaluara, sponsorë edhe të këtij turneu ishin “Cafe Timi” me pronar Mexhid Bislimin dhe shtypshkronja “Alba Kopie” me pronar Xhevat Balaj.

Me 8 shkurt 2013 shoqata kulturo-sportive “Arberia” është regjistruar edhe zyrtarisht pranë autoriteteve përkatëse austriake, ndërsa synon që këtë vit të kyçet edhe në ligën austriake të shahut.

<sup>18</sup> <http://youtu.be/8Qw0UGPnGIg>